



# DRUNJTË NË PEISAZHIN E QYTETIT

---



## UDHËZUES PËR VENDIMMARRËS





# "DRUNJTË NË PEISAZHIN E QYTETIT"

## UDHËZUES PËR VENDIMMARRËS

Autor: © Trees & Design Action Group

Botues : EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren & Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

Qershor, 2020



Perkthimi i dokumentit “DRUNJTË NË PEISAZHIN E QYTETIT - UDHËZUES PËR VENDIMMARRËS”  
eshte realizuar nga EC Ma Ndryshe, mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe  
Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që  
implementohet nga Community Development Fund – CDF.  
Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

SHËNIM: "DRUNJTË NË PEISAZHIN E QYTETIT - UDHËZUES PËR VENDIMMARRËS" ËSHTË PËRKTHYER DHE  
PËRSHTATUR NGA DOKUMENTI "TREES IN THE TOWNSCAPE - A GUIDE FOR DECISION MAKERS" PUBLIKUAR  
NGA **TREES & DESIGN ACTION GROUP**. KY PUBLIKIM I OFROHET VENDIMMARRËSVE KOSOVARË NË VERZIONIN  
SHQIP ME QËLLIM TË ADAPTIMIT TË PRINCIPLEVE DHE PRAKTIKAVE TË MIRA TË UDHËZUARA NË PËRMBAJTJEN  
ORIGINALE TË KETIJ DOKUMENTI.


TË DREJTAT AUTORIALE MBI PËRMBAJTJEN E KËTIJ DOKUMENTI I TAKOJNË ©**TREES & DESIGN ACTION GROUP**

# Drunjtë urban të shekullit 21...

Drunjtë i bëjnë vendet të funksionojnë, të duken dhe të ndjehen më mirë.

Përveç që luajnë rol në përmirësimin e klimës në lagjet tona si dhe i ndihmojnë mirëqenies së shëndetit të njeriut dhe ambientit, drunjtë mund të ndihmojnë edhe në krijimin e kushteve për përparim ekonomik.

Ky udhëzues paraqet qasjen e shekullit 21 për drunjtë urban, duke u ofruar vendimmarrësve parimet dhe referencat e nevojshme për të realizuar këtë potencial në tërësi.



Drunjtë kanë rëndësi për lagjet, si dhe për qytetet e vogla e të mëdha të shekullit 21. Derisa 80% e popullatës së Mbretërisë së Bashkuar jeton në mjedise urbane, drunjtë në zonat me ndërtesa dhe përreth tyre – të cilët shumica i quajnë “pyje urbane” – janë bërë komponentë kyçe e infrastrukturës të cilët bëjnë që vendet të funksionojnë, të duken dhe të ndjehen më mirë.

Drunjtë janë pjesë e zgjidhjeve për shumë sfida të rëndësishme të kohës sonë, që nga ndryshimi klimatik deri te shëndeti dhe mirëqenia në rënie. Drunjtë shërbejnë për restaurimin mjedisor dhe baraspeshën shoqërore në lagjet dhe qendrat e qytetit duke kontribuar në kushtet për përparim ekonomik. Për më shumë, këtë mund ta bëjnë me çmim shumë më të leverdishëm se sa disa forma tradicionale të infrastrukturës. Marrim për shembull menaxhimin e ujërave të shiut, ftohjen urbane, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe kënaqësinë e pamjes shumëgjyreshe të stinës: asnjë aset i vetëm i krijuar nga dora e njeriut nuk do kishte vlerën që mund të ofrojë një dru i rritur.

Ideja e pyllit urban mund të duket oksimoron. Megjithatë termi përdoret ndërkombëtarisht për të theksuar rëndësinë e menaxhimit të drunjve urban si tërësi për të sjellë dobi shoqërore, ekonomike e mjedisore për komunitetin lokal. Rezultatet e hulumtimit dhe mjetet e disponueshme për vlerësimin e dobive të drunjve përbëjnë një shembull të fuqishëm për këtë qasje. Për shembull, në Torbay, vetëm kontributi që drunjtë lokal japin në largimin e ndotjes së ajrit dhe izolimin e karbonit është vlerësuar të jetë 6.4 milionë funte në vit. Në këtë kontekst nuk është befasi të shohim që drunjtë urban ta kenë vëmendjen në rritje në vendimmarrjen politike. Më 2010 qeveria e MB nisi fushatën kombëtare të mbjelljes së drunjve Big Tree Plant, krahas së cilës kryebashkiaku i Londrës filloi nismën RE:LEAF që kishte për qëllim rritjen e mbulimit të Londrës me drunj. Tutje, kryebashkiakët e tri qyteteve më të mëdha në SHBA – Los Anxhelos, Nju Jork dhe Çikago – kanë filluar

programe ambicioze të pyjeve urbane për të mbjellë dhe ofruar administrim afatgjatë për një milionë drunj përgjatë disa viteve të ardhshme.

### **Ky udhëzues ka 12 parime**

Qyteteve të shekullit 21 u duhet qasje e shekullit 21 ndaj drunjve – një që shkon krahas dhe u përgjigjet sfidave të kohës sonë.

Drunjtë në pamjen e qytetit ofron një grup gjithëpërfshirës të 12 parimeve me veprime praktike që mund të adaptohen sipas kontekstit unik të qytetit për të ofruar një program për drunjtë në kontekst të shekullit 21. Drunjtë në pamjen e qytetit përqendrohet në drunjtë individual në pyjet urbane, qofshin drunj të rrugëve kryesore, drunj në zona të hapura publike dhe hapësira banimi apo drunj privat që nuk e mbulojnë menaxhimin e kurorës pyjore.

### **Kush duhet të përdorë 12 parimet?**

12 parimet e Drunjtë në pamjen e qytetit janë për këdo që është i përfshirë në marrjen apo ndikimin e vendimeve që u japin formë hapësirave dhe vendeve në të cilat jetojmë. Posaçërisht do jetë relevant për të zgjedhurit në nivel lokal, politikbërësit dhe grupet e komunitetit bashkë me pronarët e pronave të mëdha, siç janë pronarët shoqëror të regjistruar. Gjithashtu do jetë e dobishme për profesionistët që me ekspertizën e tyre teknike lehtësojnë dërgesat, siç janë inxhinierët, arkitektët, arkitektët e peizazheve apo dizajnerët urbanë.

### **Si janë zhvilluar 12 parimet?**

Ky udhëzues është zhvilluar nga Trees and Design Action Group (TDAG) bazuar në më se 40 intervista dhe konsultime me njohës të mirë në sektorin e ndërtimit të mjedisit duke përfshirë inxhinierë, përfaqësues sigurimesh, zhvillues, planifikues, zyrtarë për drunj, ekspertë të qëndrueshmërisë, rojtarë pyjesh, menaxherë fidanishtesh, ekologë, akademikë, dhe organizata jo fitimprurëse të specializuara në angazhime me komunitetin dhe drunjtë .

# 12 PARIMET

## PLANIFIKO

1/ Njih burimin e drunjve

2/ Krijohet strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

3/ Fut drunj të në Politikë dhe Plane të tjera

### Lojtarët kyç

Përkrahja e angazhimit në nivel komiteti apo bordi  
**Planifikuesi i Këshillit Lokal**  
**Zyrtari për Qëndrueshmëri, Banim, Rrugë kryesore dhe Zona të hapura**  
**Zyrtari për drunj Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve**  
Udhëheqja e shkrimit të politikave dhe zbatimit

### Veprimet kyçe

- Vendos kush çfarë duhet të dijë
- Ndërto një fotografi të madhe duke e kuptuar pyllin tënd urban
- Shtohet detaje aty ku ka nevojë
- Krijohet ambient pranues përmes përkrahjes, angazhimit dhe ndërtimit të konsensusit
- Përcakto politikat dhe zhvillo një plan veprimi
- Monitoro, mëso dhe rishiko
- Adopto rregullat bazë për menaxhimin e drunjve, duke përfshirë standarde të hollësishme për zhvendosjen dhe mbjelljen e drurëve
- Cakto burime për zbatimin e politikave
- Vendos drunj të në plane të tjera

## DIZAJNO

4/ Krijohet vende në harmoni me drunj të

5/ Zgjedh drunj të e duhur

6/ Kërko përfitime të shumëfishta

### Lojtarët kyç

Sill planet për takime e propozime  
**Planifikues/Zyrtar për Kontroll të Zhvillimit Zhvillues/Pronar zone Dizajner**  
**Zyrtar për drunj Inxhinier**  
**Ofrues i shërbimeve komunale**  
**Roje pyjesh Fidanishte**  
Integro infrastrukturën e gjelbër dhe të hirtë për rezultate më të gjera

### Veprimet kyçe

- Favorizohet drunj më të mëdhenj
- Hulumto drunj të ekzistues
- Përfshij çështjet nëntokësore – veglat, bazat
- Harto plan të fuqishëm për mbrojtjen e drunjve
- Merr parasysh dobitë e pritura dhe funksionet e drunjve
- Përdor kontekstin për të paraqitur procesin e përzgjedhjes
- Hulumto përmbajtjet e zonës, siç janë llojet e dheut dhe drita
- Drejtoju specialistëve për këshilla
- Shiko se si mund të jenë drunj të pjesë e infrastrukturës, siç është qetësimi i trafikut, ofrimi i rrethimit, mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike dhe programeve për shëndetin publik

## MBJELL/MBROJ

7/ Gjej dru të shëndoshë

8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

9/ Krijo hisedarë

### Lojtarët kyç

Kërko dhe mbështet standarde pune të cilësisë së lartë

**Zyrtar për drunj**

**Pronar zone**

**Komunitetet**

**Kujdestar drurësh**

**Kontraktues dhe**

**nënkontraktues**

**Organizata vullnetare për drunj**

Zgjero njohuritë, pronësitë dhe pjesëmarrjen

### Veprimet kyçe

- Kupto sistemin e prodhimit të drunjve dhe përdor specifikat
- Kryej vizita në fidanishte
- 
- Bëje vëllimin e dheut prioritetin kryesor
- Siguro ujitje dhe mbikëqyrje të mjaftueshme
- Angazho individë të trajnuar për të bërë mbjelljen
- 
- Hulumto teknologji të reja të mbjelljes
- Përfshij komunitetet lokale dhe staf të trajnuar
- Siguro që puna në dhe përreth drunjve të përmbush standardet e cilësisë

## MENAXHO/MONITORO

10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

### Lojtarët kyç

Zgjedh intervenimet proaktive në vend të atyre reaktive

**Pronar zone**

**Zyrtar për drunj**

**Autoriteti i rrugës**

**kryesor**

**Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve**


**Sigurimet**

**Roje pyjesh**

Kushtoji vëmendje dobive para kohës

### Veprimet kyçe

- Vlerëso vlerën e burimeve të drunjve
- Shkallëzo buxhetin dhe kompensimet në përputhshmëri
- 
- Kupto detyrën tënde për tu kujdesur
- Menaxho rreziqet dhe dobisë në varg
- Arsyeto inspektimin e drunjve përmes zonimit
- 
- Kompjuterizo çështjet e prerjes, menaxhimit dhe inspektimit
- Promovo menaxhmentet që kujdesen për biodiversitetin
- Merr parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike



Pika fillestare e suksesit është të kuptosh se ku je dhe ku dëshiron të shkosh. Parimet e Planifikimit do ju ndihmojnë të punoni me të tjerët, duke përfshirë këshilltarët, planifikuesit dhe zyrtarët kryesor që shpien kah qëndrueshmëria, banimi, rrugët, hapësirat e gjelbra dhe drunjtë, bashkë me vullnetarë të komunitetit, biznese dhe banorë, për të krijuar themelet e forta për strategjinë tuaj për drunjtë.

# PLANIFIKO

1/ Njih burimin e drunjve

2/ Krijë strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

3/ Fut drunjte në Politikë dhe Plane të tjera

4/ Krijë vende në harmoni me drunjte

5/ Zgjedh drunjte e duhur

6/ Kërko përfitime të shumëfishta

7/ Gjej dru të shëndoshë

8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

9/ Krijë hisedarë

10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave



# Njih burimin e drunjve

## Objektivi

Krijo dhe mirëmbajë të dhëna të lehta për përdorim të kurorës pyjore dhe natyrës si dhe gjendjes së popullsisë së drunjve.

## Dobitë

- Ndiemon në vendosjen e drunjve në pozitën e njëjtë me tipet e tjera të infrastrukturës kur kemi të bëjmë me vendimmarrje duke u siguruar që provat e nevojshme të mbështeten me modele.
- Ofron një bazë për monitorimin e progresit dhe rezultateve, duke lejuar vlerësimin e zhvillimit dhe menaxhimit të drunjve.
- Ofron provat e nevojshme për politika të fuqishme dhe efektive, posaçërisht në raport me mbrojtjen e peizazhit, ruajtjen e drunjve, obligimet e planifikimit dhe kontrollin e zhvillimit.

### Veprimet kyçe

- Vendos kush çfarë duhet të dijë
- Ndërto një fotografi të madhe duke e kuptuar pyllin tënd urban
- Shto detaje aty ku ka nevojë
- 
- Krijo ambient pranues përmes përkrahjes, angazhimit dhe ndërtimit të konsensusit
- Përcakto politikat dhe zhvillo një plan veprimi
- Monitoro, mëso dhe rishiko
- 
- Adopto rregullat bazë për menaxhimin e drunjve, duke përfshirë standarde të hollësishme për zhvendosjen dhe mbjelljen e drurëve
- Cakto burime për zbatimin e politikave
- Vendosi drunjte në plane të tjera



Njih burimin e drunjve



Krijo strategji gjithëpërfshirëse të drunjve



Fut drunjte në Politikë dhe Plane të tjera

### Lojtarët kyç

Përkrahja e angazhimit në nivel komiteti apo bordi  
**Planifikuesi i Këshillit Lokal**  
 Zyrtari për Qëndrueshmëri, Banim, Rrugë kryesore dhe Zona të hapura  
 Zyrtari për drunj Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve  
 Udhëheqja e shkrimit të politikave dhe zbatimit

## Veprimet

### Sqaro nevojat e të dhënave dhe objektivat e mbledhjes së të dhënave

Si me çdo formë tjetër të menaxhimit me asete, baza e sigurimit të dobive maksimale nga drunjtë është një arsytim i qartë i asaj me çka merresh. Hapi i parë i rëndësishëm është të kuptuarit e asaj se për çfarë informatash kemi nevojë, kush do i përdorë ato, për çka dhe si. Faktor me rëndësi është edhe siguri se kriteri i mbledhjes së të dhënave përputhet me ato që kërkohen me mjetin e vlerësimit apo analizës që do përdoret (shiko Parimin 10). Qartësia për përdorimin e ardhshëm dhe nevojat e sistemit për të dhënat në raport me drunjtë nënkupton që sasia e duhur mund të mblidhet në formatin e duhur.

### Kupto kapacitetet dhe kufizimet e metodave për përvetësimin e të dhënave

Metoda të ndryshme për përvetësimin e të dhënave japin rezultate të ndryshme, disa më të hollësishme se të tjerat.

Për identifikimin e natyrës dhe kushteve të burimeve të drunjve lokal nevojiten hulumtime në terren. Vlerësimi i kurorës së gjithëmbarshme pyjore në një zonë, mund të bazohet në punën e hulumtimeve në terren përmes llogaritjeve të madhësisë vizuale. Kurora pyjore mund të vlerësohet nga largësia me përdorimin e sistemit të informacionit gjeografik (GIS) dhe pamjeve ajrore apo satelitore që të hartojë në mënyrë manuale apo automatike kurorat e drunjve. Kur nuk janë të mundura hulumtimet e plota (apo analiza e plotë e kurorës pyjore nga larg) duhet të përdoren teknikat e mostrave në mënyrë që të dhënat e mbledhura të mund të prodhojnë një profil të besueshëm të popullatës së përgjithshme të drunjve. Sa më automatik të jetë procesi i mbledhjes së të dhënave dhe sa më të vogla e më me pak kujdes të gjykuara mostrat e përdorura, aq më të hollësishme rezultatet e prodhuara. Është thelbësor kuptimi i pikave të forta dhe kufizimeve të qasjes së marrë në lidhje me shkallën e finesës dhe fortësisë së nevojshme.

### Rriteni vullnetarizmin dhe burimin e turmës

Ndihmë të çmuar për hulumtimet në terren, mund të ofrojnë vullnetarë të trajnuar dhe menaxhuar në mënyrë adekuate, siç janë kujdestarët e drunjve dhe anëtarët e organizatave siç janë Trees for Cities apo Woodland Trust. Që nga viti 2004, projekti Ancient Tree Hunt (ATH) i udhëhequr nga Woodland Trust dhe Ancient Tree Forum ka demonstruar se si komunitetet mund të përdoren në mënyrë efektive për monitorim dhe hartimin e drunjve antik përgjatë udhësive Britanike. Baza e gjallë e të dhënave prej 110.000 drunjve antik ofron një model që do mund të ishte rivalizuar në një shkallë tjetër, dhe do mund të ishte aplikuar përtej mostrave të drunjve të vjetër. Studimi The Londoners Love Trees ofron një tjetër shembull të mirë.

Pajisjet e planifikimit online dhe aplikacionet telefonike që u lejojnë anëtarëve të publikut të gjerë që të bëjnë hartën e drunjve apo të shtojnë informata në hartën e pyjeve urbane në një zonë të caktuar mund ta bëjnë procesin më të lehtë dhe shumë më argëtues. Hulumtimi i San Franciskos ofron shembullin se si kjo mund të menaxhohet me sukses. Qasje të tilla dërgojnë mbledhje të të dhënave më se të leverdishme ; ato po ashtu ndihmojnë në angazhimin dhe edukimin e komunitetit lokal për drunjtë. Për të prodhuar rezultate të besueshme, kërkohet një kornizë e fuqishme për miratimin e të dhënave dhe trajnim.


### Mundësoni qasjen në të dhëna dhe lidhni ato me sistemin e informacionit gjeografik (GIS)

Çfarëdo baze e të dhënave që mbahet, është me rëndësi që ajo të jetë e qasshme për një varg të gjerë të përdoruesve. Një planifikues lokal i intervistuar në përgatitjen e këtij udhëzuesi sqaroi se ka pasur vështirësi në zbatimin e procedurave për ruajtjen e drunjve dhe mekanizmave të tjerë për mbrojtjen e drunjve sepse baza e të dhënave që kishte të dhënat e hulumtimit të drunjve mbahej në një softuer për menaxhimin e çështjes së drunjve, leje për përdorimin e të cilit kishte vetëm zyrtari lokal për drunj. Duhet bërë të gjitha

përpjekjet për të siguruar që rezultatet e hulumtimit të drunjve lokal mund të përdorën në mënyrë të përbashkët me Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS). Kjo do të thotë se të dhënat për drunjtë dhe kurorën pyjore mund të analizohen në mënyrë hapësinore dhe në kombinim me të dhënat, të cilat janë posaçërisht të dobishme në kuptimin e nevojave, dobive dhe vlerave nga drunjtë (shiko Parimin 10).

### **Të dhënat e futura përditësohen sipas procedurave rutinore të menaxhmentit**

Të dhënat duhet të mbahen të përditësuara. Sapo të krijohet një bazë, përditësimi mund të kryhet në mënyrë të përsëritshme, duke integruar punë nga terreni përbrenda mirëmbajtjes dhe punëve të tjera të kryera në mënyrë rutinore sa më shumë që është e mundur. Zonave që përjetojnë presion apo ndryshime të shpejta mund tu duhet të hulumtohen në mënyrë të përvitshme derisa disa të tjerave një herë në tri vjet. Hapësirat mund të zonohen bazuar në nivelin e përdorimit dhe të hulumtohen në përputhje me të (shiko Parimin 11).



# 2/ Krijoni strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

## Objektivi

Prodho, përvetëso dhe zbato strategji bashkëpunuese për mbrojtjen, zhvillimin dhe menaxhimin e një pylli urban të lulëzuar i cili gjeneron përfitime dhe i cili është i akorduar me nevojat dhe aspiratat lokale.

## Dobitë

- Siguron mekanizmin më efektiv për arritje si dhe mbulim të mirë drurësh në përgjithësi.
- Ndihmon të sigurohet se merren vendime me konsensus dhe në bazë të dëshmimeve, duke kufizuar kështu hapësirën për shpërndarje të atypëratyshme të burimeve e cila mund të favorizojë më të zhurmshmit dhe të artikuluarit.
- Krijon llogaridhënie brenda për brenda afatit të caktuar kohor.
- Ofron bazë për formimin e politikave të fuqishme planifikuese në raport me drunjtë.

1/ Njih burimin e drunjve

2/ Krijoni strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera

### Lojtarët kyç

Përkrahja e angazhimit në nivel komiteti apo bordi  
**Planifikuesi i Këshillit Lokal**  
Zyrtari për Qëndrueshmëri, Banim, Rrugë kryesore dhe Zona të hapura  
Zyrtari për drunj  
**Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve**  
Udhëheqja e shkrimit të politikave dhe zbatimit

### Veprimet kyçe

- Vendos kush çfarë duhet të dijë
- Ndërto një fotografi të madhe duke e kuptuar pyllin tënd urban
- Shto detaje aty ku ka nevojë
- 
- **Krijoni ambient pranues përmes përkrahjes, angazhimit dhe ndërtimit të konsensusit**
- **Përcakto politikat dhe zhvillo një plan veprimi**
- **Monitoro, mëso dhe rishiko**
- 
- Adopto rregullat bazë për menaxhimin e drunjve, duke përfshirë standarde të hollësishme për zhvendosjen dhe mbjelljen e drurëve
- Cakto burime për zbatimin e politikave
- Vendosi drunjtë në plane të tjera

## Veprimet

### Krijoni ambient perceptues

Zhvillimi efektiv dhe zbatimi i strategjisë së drunjve kërkon sponsorizim ekzekutiv. Në një autoritet lokal, kjo më së miri arrihet kur një këshilltar, kryesues komiteti apo më së miri nga të gjitha, udhëheqësi i këshillit, është “kampioni” i dizajnuar për strategjinë.

Po aq i rëndësishëm është krijimi i grupeve punuese ndër-disiplinare, duke përfshirë përfaqësuesit kryesor nga brenda apo jashtë organizatave vendimet e të cilave kanë ndikim në drunjte lokal, apo të cilët mund të fitojnë shumë nga një menaxhim më i mirë i pyllit urban. Të kalosh kohë duke vendosur se si do të angazhohen grupet punuese me një audiencë më të gjerë është gjithashtu qenësore. Një pjesë të madhe të ndikimit që mund të ketë një strategji e drunjve del nga procesi i zhvillimi të saj. Duke ftuar për të kontribuar trupa të tjerë publik, grupe të interesit tregtar dhe biznesor, organizata vullnetare dhe grupe të komunitetit është një nga mekanizmat më efektive për të fituar mbështetjen e tyre për dërgim. Shembulli i Manchesterit më poshtë ofron shembull se si mund të bëhet kjo. (Shikoni po ashtu Parimin 9).

### Përfshij tërë pyllin urban

Është kritike përfshirja e drunjve të rrugës kryesore, drunjve në hapësira publike dhe në hapësira banimi si dhe drunjve privat në strategjitë e autoritetit lokal për drunjte. Hulumtimi gjithëpërfshirës i kryer për raportin e sponsorizuar nga qeveria Trees in Towns II ka gjetur se 70% e drunjve urban në Angli janë pjesë e pronës private. Po ashtu mekanizmat për të ndikuar te drunjte privat dallojnë nga ato në dispozicion të drunjve në hapësira publike (shiko Parimin 3 dhe 9), ata janë të rëndësishëm së njëjti për tu përfillur.

### Adreso plotësisht: Çfarë kemi? Çfarë duam? Çfarë bëjmë? A po marrim atë që duam?

Në Trees in Towns II, këto katër pyetje janë

përcaktuar si shtylla të “praktikave të mira” për prodhimin e strategjisë së drunjve.

**Çfarë kemi?** Të kuptosh natyrën dhe shtrirjen e burimeve të drunjve është pika fillestare më e mirë për çfarëdo përpjekje kuptimplote planifikimi dhe menaxhimi. Kjo do përfshijë themelimin e vlerës së përgjithshme të popullatës së drunjve lokal si dhe përshkrimin e profileve të saj në terma sasior, cilësor dhe funksional. Për më shumë detaje, shiko Parimin 1 dhe 10.

**Çfarë duam?** Posedimi i objektivave që përcaktojnë qartë se si do të duket suksesi dhe përfitimet specifike që pritet të japë pylli urban ofron një busull qenësore për veprime udhëzuese. Përcaktimi i objektivave të tilla kërkon partneritet të gjerë të hisedarëve që shkojnë përtej stafit të angazhuar me drunjte.

**Çfarë bëjmë?** Për të përmbushur rolin e vet, një strategji duhet të artikulojë politikën si dhe veprimet praktike të nevojshme për arritjen e secilës objektivë. Kjo duhet të përfshijë masa për:

-Adresimin e zonave ku drunjte mungojnë dhe janë të nevojshëm, çka mund të përfshijë vendosjen e ca synimeve për kurorën drunore, si në shembullin e Seattle më poshtë.

-Adreso disbalancin në shpërndarjen e moshës së popullatës dhe specieveve.

-Siguro që formulimi i justifikueshëm, i zbatueshëm dhe imponueshëm adoptohet si politikë dhe shkruhet në dokumentet e planifikimit lokal për autoritetet lokale. (shiko Parimin 3).


-Vendos standarde të menaxhimit që mbështesin arritjen e përfitimeve të pritura.

-Siguro që të dizajnohet një partneritet i fuqishëm dhe një program i angazhimit të komunitetit për të ushqyer pritjet (shiko Parimin 9).

**A po marrim atë që duam?** Pa progres të monitorimit, që heton atë se pse gjëra të caktuara nuk po funksionojnë si pritet dhe të adaptohen në pajtim me të, ka pak gjasa që

strategjia të arrijë objektivat e caktuara. Trees in Towns II rekomandon që një proces i tillë rishikimi të ndërmerret përafërsisht në çdo pesë vjet. Shembulli i Newcastle më poshtë demonstroi se sa efektive mund të jetë një gjë e tillë.

Referencë të dobishme për të gjitha autoritetet lokale krahas raportit Trees in Towns II, ofrojnë edhe Preparing Borough Tree and Woodland Strategies, a Supplementary Planning Guidance to the London Plan të përgatitura bashkërisht nga Kryetari i Londrës dhe Komisioni i Pylltarisë



# 3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera

## Objektivi

Adopto standarde të qarta për mbrojtjen, kujdesin dhe mbjelljen e drunjve në planin lokal dhe politikat kyçe të korporatës si dhe dokumentet e investimit.

## Dobitë

-Siguron porta performance për ata që punojnë brenda, me ose për organizatën (p.sh. kontraktorët), duke mundësuar konsistencë më të madhe punimet me drunj që janë duke u kryer dhe parashikim në rezultate.

-Ndhmon në shkarkimin e detyrës së kujdesit e shoqëruar me drunjtë.

-Ofron mekanizëm efektiv për menaxhimin e pritjeve publike, duke reduktuar kohën e shpenzuar në trajtimin e kërkesave të atypëratyshme.

-Kontribuon në sigurimin e rezultateve pozitive mjedisore nga zhvillimet e reja.

-Siguron blerje të nivelit të lartë për çështjet që lidhen me drunjtë të cilat mund ta lehtësojnë qasjen në burimet për drunjtë.

1/ Njih burimin e drunjve

2/ Krijohet strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera

### Lidhjet krye

Përkrahja e angazhimit në nivel komiteti apo bordi  
**Planifikuesi i Këshillit Lokal**  
Zyrtari për Qëndrueshmëri, Banim, Rrugë kryesore dhe Zona të hapura  
Zyrtari për drunj  
Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve  
Udhëheqja e shkrimit të politikave dhe zbatimit

### Veprimet krye

- Vendos kush çfarë duhet të dijë
- Ndërto një fotografi të madhe duke e kuptuar pyllin tënd urban
- Shto detaje aty ku ka nevojë
- 
- Krijohet ambient pranues përmes përkrahjes, angazhimit dhe ndërtimit të konsensusit
- Përcakto politikat dhe zhvillo një plan veprimi
- Monitoro, mëso dhe rishiko
- 
- Adopto rregullat bazë për menaxhimin e drunjve, duke përfshirë standarde të hollësishme për zhvendosjen dhe mbjelljen e drurëve
- Cakto burime për zbatimin e politikave
- Vendos drunjtë në plane të tjera

## Veprimet

### Shpjego dhe përvetëso në mënyrë korrekte gjërat që duhet dhe nuk duhet bërë nga ana e korporatës në lidhje me asortimentin e drunjve që e kontrollojnë

Politikat përcaktojnë parimet dhe qëllimin e veprimit për ata që janë brenda asaj organizate apo që janë nën autoritetin e saj, qoftë brenda kontekstit të qeverisë lokale apo të ndonjë organizatë tjetër. Në çfarë rrethanash mund të merret parasysh heqja e drunjve? Si dhe kur do të bëhet krasitja e drunjve? Si do të ekzaminohet roli që një dru mund të luajë në dëmin e rrëshqitjes? Çfarë qasjesh do të zgjidhen në mbjelljen dhe përzgjedhjen e specieve të drunjve? Këto janë vetëm disa rregulla bazë që do të përcaktojnë politika e një korporate për drunjë.

Për të qenë efektiv, duhet të përvetësohet një deklaratë për menaxhimin e asortimentit të drunjve të vetë organizatës, në nivelin më të lartë ekzekutiv dhe të bëhet publike për ata të cilët ka ndikim. Për shembull shikoni më poshtë studimin Tor Homes, si dhe politikat e përvetësuar nga ana e qytetit të Islington në Londër, e paraqitur në Parimin 11.

### Përfshij mbrojtjen e drunjve, zëvendësimin dhe standardet e mbjelljes në planin lokal

Përveç se kanë nevojë për rregulla të shëndosha për menaxhimin e asortimentit të vet të drunjve, autoritetet lokale kanë rol rregullues për të siguruar:

- Mbrojtjen e drunjve dhe zonave pyjore që ofrojnë vlerë të lartë të komoditetit publik, pa marrë parasysh pronësinë, qoftë ajo publike apo private.

- Sigurimi i një infrastrukture të përshtatshme të gjelbër në zhvillimet e reja. Fillimi më i mirë në përmbushjen e këtyre detyrave është posedimi i politikave të qarta dhe të justifikueshme për drunjë në planin lokal. Për të pasur sukses nevojitet dedikimi i burimeve për zbatimin e politikave të përvetësuar – por zbatimi nuk mund të ndodhë pa përkrahje politike. Kjo duhet të përfshijë deklaratime edhe të politikës së nivelit

të lartë edhe sqarime shtesë lidhur me atë se si do të interpretohen politikat. Studimet në Sefton dhe Bristol, më poshtë, ofrojnë ilustrim të asaj se si mund të funksionojë ky kombinim i politikës së nivelit të lartë me udhëzimet mbështetëse. Çështjet kritike për adresim përfshijnë:

- Përdorimi efektiv i Procedurës për Mbrojtjen e Drunjve (Tree Preservation Order – TPO) dhe Zonave të Konservimit me qëllim të mbrojtjes së drunjve të rëndësishëm dhe karakterit të peizazhit.

- Rregulla të qarta për të siguruar që prerja e një druri nuk është gjithmonë më ekonomike se sa mbrojtja e tij në kontekst të zhvillimeve të reja, dhe se zhvillimet e reja çojnë në mbjelljen e drunjve të rinj (e sqaruar më hollësisht më poshtë).

### Krijo masa për zëvendësimin dhe kompensimin e drunjve që e bëjnë më të lirë që të mbahen drunjë të mëdhenj ekzistues se sa të priten ata

Vetëm atëherë kur një dru arrin dhe jeton shkallën e pjekurisë realizohet kthimi i investimit i bërë në mbjelljen dhe kujdesin ndaj atij druri. Varësisht nga speciet, duhen 15 deri në 40 vite që një dru të rrisë mjaftueshëm kurorën për të dhënë estetikën shprehëse, heqjen e ndotjes së ajrit, menaxhimin e reshjeve, dhe përfitime të tjera. Nga perspektiva e mbrojtjes së natyrës, sa më i vjetër një dru, aq më e pasur bota e egër. Si rezultat, shkaktohet humbje e rëndësishme edhe kur mbjellja e një druri kompenson prerjen e një druri të vjetër.

Është pikërisht njohja e asaj humbje që çdo herë e më shumë autoritetet lokale sikurse edhe profesionistët të përgjegjshëm shoqëror e mjedisor po e pranojnë se zëvendësimi i drunjve dhe i masave të kompensimit po shkojnë përtej shkallës një për një, siç edhe është sqaruar në shembullin e studimit të Bristolit. Në këtë aspekt, mund të gjendet lidhshmëri edhe në sektorin privat, siç është demonstruar në studimin më poshtë të Land Securities.

### Vendos standardet e mbjelljes së drunjve për zhvillimet e reja

Vendosja e standardeve të mbjelljes së drunjve ofron një mekanizëm efektiv për të siguruar që zhvillimet e reja kontribuojnë në infrastrukturën e gjelbër çka i bënë qytetet e vogla dhe të mëdha vende më të këndshme dhe efektive për të jetuar dhe bërë biznes. Tabela më poshtë ofron disa shembuj se si standarde të tilla janë përcaktuar në autoritete të ndryshme lokale përreth vendit. Miratimi i tri standardeve të mbjelljes gjithashtu ndihmon në mbledhjen e pagesës së shkëmbimit, për mbjellje të drunjve në rastet kur rrethanat pengojnë që kërkesa të përmbushet në atë zonë. Kjo mund të ofrojë një plotësim kuptimplotë për buxhetin e mbjelljes së drunjve të autoriteteve lokale. Për efikasitet më të madh, standarde të tilla të mbjelljes duhet të plotësohen me kërkesa për vëllimin e dheut, posaçërisht për drunj të mbjellë në vende të vështira në mjedise urbane të dendura (shiko Parimin 8).

### Siguro plane të tjera që transmetojnë dhe mbështesin plotësisht aspiratat për rritjen e ardhshme dhe menaxhimin e pyjeve urbane

Nëse burimi i drunjve lokal ofron dobi të shumëllojshme atëherë ata duhet të mbështeten dhe posedohen gjerësisht. Për të realizuar aspirata e pyllit urban duhet të kapet dhe artikulohet jo vetëm në strategjinë e drunjve dhe në planin e asociuar të veprimit por gjithashtu edhe të trazohet përmes një vargu të gjerë të programeve dhe dokumenteve tematike dhe/ose të bazuara në zonë. Bazuar në pritjet kryesore lokale të burimeve të drunjve, kjo mund të përfshijë një plan qëndrueshmërie, strategji të infrastrukturës së gjelbër, strategji të shëndetit publik, apo plane transporti. Hulumtimi i mëposhtëm i Pyllit Birmingham, dhe projekti Bristol Great Bus Network i shpjeguar nën Parimin 4 ofrojnë shembuj të mëtutjeshëm.

**Tabela: Shembujt e standardeve të mbjelljes së drunjve**

Tipi (\*) Standardi: numri i drunjve

	Për vendbanim të ri	Për 100 m2 hapësirë të re tregtare	Për 100 m2 hapësirë të re industriale
Sefton <sup>(1)</sup> G	3	2	
Dacorum <sup>(2)</sup> G	1	1	0
Pylli Waltham <sup>(3)</sup> G	3	2	1.25
Kingston <sup>(4)</sup> ST	0.2	0.1	
Thanet <sup>(5)</sup> G	10% mbulim i zonës së zhvillimit		
Liverpool <sup>(6)</sup> ST	0.2	0.1	

(\*) G = kërkesat e përgjithshme për mbjellje të drunjve, p.sh. në vendbanim apo pranë; ST= kërkesat për mbjelljen e drunjve në rrugë

Burimet:

(1) Green Space, Trees and Development Supplementary Planning Document, Sefton Metropolitan Borough Council, korrik 2008 dhe Policy DQ3 saved from Sefton Metropolitan Borough Council's Unitary Development Plan

(2) Dacorum Borough Council's Core Strategy Pre-Submission Draft, Policy CS29, nëntor 2011

(3) Planning Obligations Supplementary Planning Document, Waltham Forest, nëntor 2008

(4) Planning Obligations Supplementary Planning Document, and associated Planning Obligations Contribution Matrix, Royal Borough of Kingston, mars 2010

(5) Planning Advice Note on Section 106 Contributions, Liverpool City Council

(6) Policy D2 saved from the Thanet District Council's 2006 Local Plan



**Realizimi i shumë potencialeve që ofrojnë drunjtë urban kërkon vëmendje të posaçme – sepse druri i gabuar në vendin e gabuar mund të shkaktojë më shumë dëm se sa dobi. Për të arritur rezultate më të mira për drunjtë dhe njerëzit, parimet e Dizajnit do ju ndihmojnë në përshtatjen e gjithë asaj që është e përfshirë në këtë proces– duke përfshirë zhvilluesit dhe pronarët e vendbanimeve, dizajnerët, inxhinierët dhe zyrtarët për drunj.**

# DIZAJNO

- 1/ Njih burimin e drunjve
- 2/ Krijë strategji gjithëpërfshirëse të drunjve
- 3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera
- 4/ Krijë vende në harmoni me drunjtë
- 5/ Zgjedh drunjtë e duhur
- 6/ Kërko përfitime të shumëfishta

- 7/ Gjej dru të shëndoshë
- 8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë
- 9/ Krijë hisedarë
- 10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve
- 11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)
- 12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

# 4/

## Krijo vende në harmoni me drunjtë

### Objektivi

Krijo vende ku speciet e drunjve mund të lulëzojnë dhe të japin të gjitha dobitë e veta pa shkaktuar telashe.

### Dobitë

- Siguron kushtet për krijimin e qyteteve dhe lagjeve plot gjethe.
- Redukton mundësinë e konflikteve në mes të drunjve, strukturave dhe njerëzve, duke siguruar kështu menaxhment më të butë dhe ulje të shpenzimeve.

4/

Krijo vende në harmoni me drunjtë

5/

Zgjedh drunjtë e duhur

6/

Kërko përfitime të shumëfishta

#### Lojtarët kyç

Sill planet për takime e propozime

Planifikues/Zyrtar për Kontroll të Zhvillimit Zhvillues/Pronar zone

Dizajner

Zyrtar për drunjtë

Inxhinier

Ofrues i shërbimeve komunale

Roje pyjesh

Fidanishte

Integro infrastrukturën e gjelbër dhe të hirtë për rezultate më të gjera

#### Veprimet kyçe

- Favorizo drunjtë më të mëdhenj
- Hulumto drunjtë ekzistues
- Përfshij çështjet nëntokësore – veglat, bazat
- Harto plan të fuqishëm për mbrojtjen e drunjve

- Merr parasysh dobitë e pritura dhe funksionet e drunjve
- Përdor kontekstin për të paraqitur procesin e përzgjedhjes
- Hulumto përmbajtjet e zonës, siç janë llojet e dheut dhe drita
- Drejtoju specialistëve për këshilla

- Shiko se si mund të jenë drunjtë pjesë e infrastrukturës, siç është qetësimi i trafikut, ofrimi i rrethimit, mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike dhe programeve për shëndetin publik

## Mjedisi

Parimet 4 dhe 5 kapin disa prej elementeve kyçe që mund të ndihmojnë në vënien në praktikë të thënies “druri i duhur, në vendin e duhur”. Janë dy sfera të cilat duhet të merren parasysh: përzgjedhja dhe vendosja e drunjve në bazë të një vlerësimi të mirëfilltë të kontekstit; dhe sigurimi se dizajni i strukturave përreth lejon që drunjtë të lulëzojnë. Këtu në vend të parë vlerësohet rëndësia e vendeve që janë në harmoni me drunjtë sepse paracakton në masë të madhe vetë mundësinë e pasjes apo jo të ndonjë druri në peizazhin urban. Kjo nuk nënkupton se duhet të presim që të gjitha vendet të strehojnë drunj, por më shumë që të shmanget përjashtimi i tyre si rezultat i planifikimit.

Krijimi i vendeve që lehtësojnë bashkëjetesën e drunjve dhe strukturave kërkon të menduar të integruar në atë që këto të dyja përshtaten së bashku në tokë dhe nën të përgjatë jetës së drurit deri në pjekuri dhe përtej saj. Drunjtë mund tu mbijetojnë lehtë shumicës së komponentëve të vështira të gjendura përreth tyre në mjedise urbane, siç janë bankat, llambat, materialet për shtrim, bile edhe shumë ndërtesa. Prandaj ka kuptim që të bëhen rregullime për të siguruar që komponentët e vrazhda jetëshkurtra në qytete të dizajnohen me drunjtë në mendje, se sa anasjelltas. Për të lexuar më shumë lidhur me këtë, udhëzuesi CIRIA, *Large species trees in urban landscapes – a design and management guide*, ofron referencë të dobishme.

## Veprimet

### Mundësitë në favor të drunjve të mëdhenj

Një mundësi e favorshme për përfshirjen e kurorave të mëdha të drunjve duhet të jetë pjesë e kontekstit politik (shiko parimin 3). Duhet të kihet parasysh në përmbledhjet e zhvillimit të prodhuara nga autoritetet lokale vënia e parimeve udhëzuese për zhvillimet e reja të mëdha si dhe në çdo përmbledhje tjetër projekti për të drejtuar ripërtëritjen apo rinovimin e hapësirave publike. Për zhvillime të

reja, diskutimet para aplikimit ofrojnë një mundësi të rëndësishme, në mënyrë që të mund të komunikohet qartas me aplikantët dhe ekipet e tyre te dizajnit.

Kryej herët një hulumtim për drunjtë ekzistues Krijimi i një mjedisi në harmoni me drunjtë fillon me kuptimin e asaj se ku janë drunjtë ekzistues në mënyrë që të sigurohet se janë marrë parasysh nevojat e tyre, dhe nëse është e përshtatshme, mund të identifikohet mbjellja. Planifikimi i aplikimeve në mënyrë rutinë kërkon që cilido dru ekzistues që mund të preket nga zhvillimi i propozuar, qoftë në atë vend apo përreth, duhet të protokollohet dhe llogaritet. Informatat për ekipin projektues duhet të mblidhen dhe të bëhen të disponueshme sa më herët që të jetë e mundur.

### Nxitni përdorimin e gypave të përbashkët për infrastrukturën nëntokësore

Kuptimi dhe kufizimi i përmbajtjeve nëntokësore është thelbësor për krijimin e vendeve në harmoni me drunjtë. Kjo përfshinë kushtet dhe tipet e dheut, veçanërisht nivelet e ngjeshjes (shiko Parimin 8) si dhe vendin e infrastrukturës nëntokësore. Përdorimi i gypave të përbashkët për aparatën e infrastrukturës nëntokësore duhet të konsiderohet prioritet, i shkruar në përmbledhjet e zhvillimit dhe i bërë kusht planifikimi për zhvillimet e reja. Kjo përfaqëson një praktikë të zakonshme dhe të leverdishme për zonat që kanë qenë të pazhvilluara më parë. Në zonat ekzistuese urbane zhvendosja e infrastrukturës nëntokësore vjen me një çmim shtesë por përfitimet shkojnë shumë përtej drunjve. Përdorimi i gypave të përbashkët e lehtëson në masë të madhe infrastrukturën e ardhshme nëntokësore dhe minimizon rrëmujën në rrugë.


### Përzgjidhni themelet adekuate të ndërtesave sipas gjendjes së dheut

Themelet e ndërtesave kërkojnë vëmendje të veçantë për të siguruar bashkëjetesën e drunjve dhe ndërtesave. Kjo është e një rëndësie të veçantë te dherat me argjilë

tkurrëse ku ekziston rreziku i rrëshqitjes (shiko parimin 11). Në kontekste të tilla, duhet të preferohet përdorimi i themeleve të thella e të projektuara, siç demonstrohet në rastin e Wauconda National Bank më poshtë.

**Sigurohu që të adresohen rreziqet e parashikueshme përgjatë procesit të zhvillimit në një plan për mbrojtjen e drunjve.**

Sigurimi që vendet të jenë në harmoni me drunjat duhet të vazhdojë edhe pas fillimit të ndërtimit, me që kjo është koha kur drunjat ekzistues rrezikojnë të dëmtohen (shiko Parimin 9). Burime tipike të rrezikut përfshijnë shpërthimet në vendngjarje, menaxhimi i shembjes dhe pastrimi i vendngjarjes, niveli i gërmimit dhe menaxhimi i ndërtimit. Këto çështje duhet të ekzaminohen aty ku është e përshtatshme gjatë fazave të dizajnit të projektit, përmes prodhimit të një plani për mbrojtjen e drunjve dhe metoda që ndërlidhen me ta. Po ashtu është i dobishëm edhe organizimi i një vizite paraprake në vendngjarje në mënyrë që të shënjohet zona e mbrojtjes së drunjve para se të fillojë ndërtimi.



# 5/ Zgjedh drunjtë e duhur

## Objektivi

Përzgjidhni dhe përdorni drunjtë në përputhje me kontekstin

## Dobitë

- Rritë sigurinë e rezultateve për të gjithë.
- Përmirëson mundësitë për arritjen e një peizazhi të arrirë për punë.
- Shmang shpenzimet e riparimit.

4/ Krijohet vende në harmoni me drunjtë

5/ Zgjedh drunjtë e duhur

6/ Kërko përfitime të shumfishta

### Lojtarët kyç

Sill planet për takime e propozime  
**Planifikues/Zyrtar për Kontroll të Zhvillimit Zhvillues/Pronar zone Dizajner Zyrtar për drunjtë Inxhinier Ofrues i shërbimeve komunale Roje pyjesh Fidanishte**  
Integro infrastrukturën e gjelbër dhe të hirtë për rezultate më të gjera

### Veprimet kyçe

- Favorizo drunjtë më të mëdhenj
  - Hulumto drunjtë ekzistues
  - Përfshij çështjet nëntokësore – veglat, bazat
  - Harto plan të fuqishëm për mbrojtjen e drunjtëve
- 
- Merr parasysh dobitë e pritura dhe funksionet e drunjtëve
  - Përdor kontekstin për të paraqitur procesin e përzgjedhjes
  - Hulumto përmbajtjet e zonës, siç janë llojet e dheut dhe drita
  - Drejtoju specialistëve për këshilla
- 
- Shiko se si mund të jenë drunjtë pjesë e infrastrukturës, siç është qetësimi i trafikut, ofrimi i rrethimit, mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike dhe programeve për shëndetin publik

## Veprimet

### Për sukses afatgjatë merrni parasysh gamën e plotë të faktorëve

Siç e thonë në Këshillin për Drunjtë, faktori thelbësor për zgjedhjen e një druri është se “gjeneratat e pa lindura do ju falënderojnë për të” (Trees in Your Ground, fq.40). Faktorët që duhet pasur parasysh lidhen me drunjtë, vendin dhe njerëzit që do e mirëmbajnë. Kjo mund të përfshijë:

-Funksionin: dobitë e dëshiruara nga druri – shiko Parimin 6.

- Karakterin: karakteri historik dhe peizazhor i zonës.

-Diversitetin: karakteristikat e profilit të një popullate më të gjerë të drunjve-shiko Parimin 1.

-Dizajnin: shkalla, baraspesha, ndikimi, ndërtimi, ngjyra e pritje nga druri.

-Përbërjen e zonës, duke përfshirë:

-Tipet dhe kushtet e dheut, sasinë e diellit, lartësinë e ndërtesave përreth, dhe hapësirën në dispozicion edhe sipër edhe nën dhe.

-Telashet e mundshme, duke përfshirë: polenin, pengimin e dritës për hapësirat e banueshme, tërheqjen për CCTV, ndriçimin rrugor, hapësirën për kabllot mbitokësore dhe makinat.

-Rrezikun e dëmit që druri mund tua shkaktojë strukturave – kjo kërkon informacion për tipin e dheut, speciet e drunjve dhe karakteristikat sikurse edhe dizajni i themeleve.

-Kapacitetin mbështetës: rreshtimi me aspiratat e komunitetit si dhe me menaxhimin afatgjatë dhe kapacitetin e mirëmbajtjes.

### Ndërto vlerë ekologjike dhe ripërtëritëse

Elementet e rëndësishme ekologjike për përzgjedhjen e specieve shpesh ngushtohen në një debat lidhur me atë se a duhet apo jo të preferohen sistematikisht drunjtë vendor. Një formulim i tillë e zhvendos vëmendjen nga një qasje e balancuar që merr në konsideratë edhe vlerat ekologjike edhe ripërtëritëse.

Nga një këndvështrim i vlerave ekologjike dhe siç theksohet tutje në Parimin 6, drunjtë mund të luajnë rol kritik në rritjen e jetës së egër urbane, për shkak të gamës së gjerë të cilat mund ti mbështesin speciet pakurizore dhe speciet e lidhura me to.

Rritja e ripërtëritjes ekologjike për sëmundjet dhe ndryshimin klimatik kërkon një popullatë vendore të drunjve me një llojllojshmëri të

madhe. Kjo është me rëndësi të merret në konsideratë edhe për nivelin e specieve edhe të gjeneve. Kur drunjtë e mbjellë janë identik, siç i kemi parë te Rrapet e Londrës gjatë epokës Viktoriane, dobësia e pyllit urban në një tharje të shpejtë dhe të tërësishme është shtuar shumë. Ky rrezik mund të zvogëlohet me kushtimin e një vëmendje më të madhe në diversifikimin e rezervës së gjeneve të mostrave të drunjve të ri që po mbillen (shiko Parimin 7 lidhur me gjetjet), dhe të marrësh nga një listë e shumëllojshme e mbjelljes edhe vendore edhe jo-vendore e përshtatshme për lloje të ndryshme të vendbanimeve urbane.

### Mos lejo të kalojnë drunjtë pa u përmendur në përmbledhjet e zhvillimit

Përmbledhjet e zhvillimit të prodhuara nga planifikuesit e autoriteteve lokale ofrojnë një mundësi të mirë për të ndërtuar sipas politikave të shkruara në planin lokal (shiko Parimin 3) dhe për të vendosur pritje të veçanta për zonën duke marrë parasysh përfshirjen e drunjve në zhvillimet e reja. (Shiko shembullin e përmbledhjes së zhvillimit të Poundbury). Të gjashtë faktorët e paraqitur më lartë ofrojnë një kornizë të dobishme për zhvillimin e një udhëzimi të tillë kontekstual. Nëse planifikuesit lokal prodhojnë përmbledhje zhvillimi që mbulojnë në mënyrë adekuate pritjet që lidhen me drunjtë, atyre u duhen analiza të lehta për përdorim të popullatës së drunjve lokal dhe kontekstit që në mënyrë adekuate të mbulojnë kontributin që drunjtë japin për karakterin dhe identitetin lokal. Prandaj është e rëndësishme të:

-Përfshihen planifikues lokal në përcaktimin e të dhënave të nevojshme lidhur me drunjtë (shiko Parimin 1).

-Sigurohet që planifikuesit të kërkojnë që të mbulohet roli i drunjve kur të autorizohet vlerësimi i karakterit të peizazhit.



# Kërko përfitime të shumëfishta

## Objektivi

Mbledh të gjithë gamën e dobive që drunjtë mund të ofrojnë si pjesë e sistemit të gjelbër vendor infrastrukturor, duke u përqendruar në aspiratat lokale.

## Dobitë

- Redukton nevojën për projektet e infrastrukturës së hirtë (shpesh më e kushtueshme) në mënyrë që të plotësohen me sukses nevojat e komuniteteve lokale.
- Rrit kthimin e investimit në shpenzimet kapitale dhe të ardhurave të shpenzuara për drunjtë.
- Stimulon pronësinë më të gjerë të burimeve lokale të drunjve.

4/

Krijo vende në harmoni me drunjtë

5/

Zgjedh drunjtë e duhur

6/

Kërko përfitime të shumëfishta

### Lojtarët kyç

Sill planet për takime e propozime

Planifikues/Zyrtar për Kontroll të Zhvillimit Zhvillues/Pronar zone

Dizajner

Zyrtar për drunj

Inxhinier

Ofrues i shërbimeve komunale

Roje pyjesh

Fidanishte

Integro infrastrukturën e gjelbër dhe të hirtë për rezultate më të gjera

### Veprimet kyçe

- Favorizo drunj më të mëdhenj
- Hulumto drunjtë ekzistues
- Përfshij çështjet nëntokësore – veglat, bazat
- Harto plan të fuqishëm për mbrojtjen e drunjve
- 
- Merr parasysh dobitë e pritura dhe funksionet e drunjve
- Përdor kontekstin për të paraqitur procesin e përzgjedhjes
- Hulumto përmbajtjet e zonës, siç janë llojet e dheut dhe drita
- Drejtoju specialistëve për këshilla
- 
- **Shiko se si mund të jenë drunjtë pjesë e infrastrukturës, siç është qetësimi i trafikut, ofrimi i rrethimit, mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike dhe programeve për shëndetin publik**

## Veprimet

### Shikoni aspektin tërësor

Përfshirja apo ruajtja e drunjve qaset më së miri si mjet drejt një përfundimi, më shumë se sa një përfundim në vete. Kur drunjte përzgjedhjen, integrohen dhe menaxhohen në mënyrë adekuate ata kanë potencial të luajnë rol kyç në mesin e elementëve tjerë të infrastrukturës së gjelbër, në ndihmën për përmbushjen e nevojave të banorëve, bizneseve dhe përdoruesve tjerë. Kur shqyrtohen aspiratat për një lagje, një rrugë apo edhe një vend të vetëm, duhet gjithmonë që të shtrohen pyetjet: si mund ta mbështesin drunjte vizionin për këtë vend? Si mund të ofrojnë drunjte zgjidhje për çështjet e identifikuar? Një mendësi e tillë ndihmon në identifikimin e zgjidhjeve që pranohen më gjerësisht, janë më të leverdishme prandaj edhe më të qëndrueshme. Dizajnimi me drunj është çështje e përpjekjes për të arritur një baraspeshë në mes të sigurimit të përfitimeve maksimale të kërkuara me mangësitë më të pakta të mundshme.

### Shqyrtoni – dhe nëse është relevante, dizajnoni-kontributin që drunjte mund të japin në:

#### Cilësinë e vendit

Drunjtë kanë një rol të rëndësishëm estetik në peizazhin e qyteteve tona për shumë arsye. Siç e ka shpjeguar Henry Arnold “ata krijojnë ritme hapësinore për të nxjerr në pah përvojën e lëvizjes nëpër hapësirat e jashtme.” Drunjte po ashtu krijojnë një ndjenjë shkalle që na bëjnë të ndjehemi më rahat, na sjellin kënaqësi me ndryshimin e ngjyrave dhe gjetheve të tyre nëpër stinë, e ulin dritën nëpër motivet e hijes në mure, trotuare e ndërtesa.

#### Potencialin ekonomik

Drunjtë kontribuojnë pozitivisht në krijimin e vendeve që janë të mira për biznes. Studimet e kryera nga Kathleen Wolf në Universitetin e Uashingtonit në SHBA kanë treguar se

prezenca e drunjve në zonat e tregtisë ndikojnë pozitivisht edhe në perceptimin edhe sjelljen e blerësve.

Raportohet se rrugët e përvijuara me drunj të pjekur ulin kohën e shitjes për tipare banimi dhe mbështesin vlera më të fuqishme në treg.

### Shëndetin dhe mirëqenien

Drunjtë ndikojnë edhe në shëndetin fizik edhe në atë mental të komuniteteve lokale. Përdorimi i drunjve për largimin e ndotësve të ajrit mund të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë për frenimin e sëmundjeve të frymëmarrjes, siç ilustron nga iniciativa më poshtë e Zonës Natyrale të Përmirësimit të Shëndetit në Birmingham. Drunjte po ashtu kontribuojnë në krijimin e hapësirave tërheqëse për ecje, çiklizëm dhe vrapim në rrugë dhe parqe, duke lehtësuar kështu adoptime më të gjera për një stil jetese më aktiv.

Qasja në drunj dhe hapësira të gjelbra është vërtetuar se ndihmon në procesin e rikuperimit dhe shpejton kohën e shërimit në spital. Krijimi i “parkut të shëndetit” si pjesë e zgjerimit të fundit të spitalit të fëmijëve Alder Hey në Liverpul është një shembull i mirë i asaj se si profesionistët shëndetësor po kërkojnë gjithnjë e më shumë të menaxhojnë dhe dizajnojnë terrenin e tyre për vlerat terapeutike që mund të ofrojnë.

Drunjtë mund të ndihmojnë gjithashtu edhe në krijimin e mjediseve që zvogëlojnë stresin, lehtësojnë problemet e shëndetit mendor dhe përmirësojnë dinamikën ndërpersonale. Një hulumtim i gjerë është kryer nga William Sullivan dhe Frances Kuo në një strehë të madhe të banimit social në Çikago në dy blloqe apartamentesh gati identike të cilat dallojnë vetëm për nga sasia e drunjve dhe barit që rritet përreth. Gjetjet e hulumtimit ishin se banorët që jetonin në banesat e rrethuara me drunj, përdornin metoda më konstruktive dhe më pak të dhunshme në përballje me konfliktin.

## **Mbrojtjen e natyrës dhe lidhjen e vendbanimit**

Drunjtë e sjellin natyrën në qytet në shumë mënyra. Drunjtë luajnë rolin e urave, duke ofruar lidhjen e specieve në një peizazh urban. Derisa jo të gjithë drunjtë kanë vlera të larta të biodiversitetit, disa mund të operojnë si specie bazë që janë qenësore për mbijetesën e shumë specieve të tjera, duke përfshirë pakurrizorët, likenet dhe kërpudhat, duke ofruar bazën e një zinxhiri të ushqimit të shëndetshëm nga i cili përfitojnë zogjtë dhe gjitarët. Speciet e drunjve që janë efektive në mbështetjen e një bote të egër të pasur do jenë më të prira për ta realizuar plotësisht këtë potencial kur rriten në pjesë më pak stresuese të peizazhit urban, siç janë parqet e mëdha, varrezat apo terrene të tjera me menaxhim të përshtatshëm.

## **Ushqimin vendor dhe lidhjet e komunitetit**

Drunjtë frutor mund të jenë një shtesë e mrekullueshme në iniciativën për ushqim vendor. Mbjellja e drunjve të ri frutor të komunitetit në hapësira të përdorura pak dhe në terrene banimi, ose edhe përgjatë rrugëve, mund të ndihmojë në adresimin sasisë së vogël të ndarjes urbane aktuale dhe tu ofrojnë komuniteteve mundësinë e rizbulimit të kënaqësive të ngrënies së frutave të rritura afër shtëpisë.

## **Qetësimin e trafikut**

Drunjtë e vendosur me kujdes mund të përmirësojnë pamjen dhe ndihmojnë në ngadalësimin e veturave. Brenda vendbanimeve urbane ata mund të përdoren si alternativë për shtyllat dhe policët e shtrirë apo për fuqizimin e pranisë dhe rritjen e rolit të një kufizimi qendror, siç përshkruhet me korridoret e Whiteladies në Bristol.

## **Menaxhimin e reshjeve**

Drunjtë mund të ndihmojnë në reduktimin e rënies së ujit të reshjeve dhe atë mund ta bëjë në disa mënyra. Kurorat e tyre i zënë rrugën shiut dhe e mbajnë një pjesë të rëndësishme të tij në gjethe dhe në lëvore. Një pjesë e ujit

të kapur do të avullohet dhe një pjesë do bjerë gradualisht në dheun nën. Nën tokë, dheu në të cilin rriten drunjtë do të infiltrohet dhe do ta ruajë ujin, një proces i ndihmuar nga rrënjët e drurit. Sa më i madh druri dhe kurora e tij, aq më i madh ndikimi. Dizajnet inovative të gropave të drunjve mund të krijojnë edhe kushte më të mira nëntokësore për rritjen e drurit edhe të rrisë dobisë e menaxhimit më të mirë të ujit të reshjeve.

## **Kontrollin e ndotjes së ajrit**

Të gjithë drunjtë luajnë rolin e filterëve të ajrit. Sikurse me dobisë e ujit të reshjeve, madhësia e drunjve ka rol të rëndësishëm. Sidoqoftë, jo të gjitha varietetet e kryejnë këtë funksion në përmasën e njëjtë dhe në kontakt me gamën e plotë të ndotësve urban të ajrit që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut. Gazrat si dyoksidi i nitrogjenit dhe ozoni kapen në stomatin (aparatin e frymëmarrjes) së gjetheve. Drunjtë me më shumë hapësirë të gjetheve i kapin gazrat dhe i grimcojnë në mënyrë efektive. Drunjtë mund të formojnë pjesë të strategjisë për kontrollin e ndotjes së ajrit në shkallë rajonale (shiko Parimin 2).


## **Ftohjen dhe strehimin**


Drunjtë mund të ndikojnë në temperaturat e ambientit përreth ndërtesave duke ofruar hije nga dielli dhe strehë nga erërat e forta dhe kjo mund të reduktojë përdorimin e energjisë qoftë për ngrohje ashtu edhe për ftohje. Hija e drunjve në verë, derisa e zvogëlon dritën për banesat, do tregohet shumë e dobishme me efektet e parashikuara të ndryshimeve klimatike kurse drunjtë gjetthor do lejojnë qasje mirëseardhëse për diellin në dimër.

## **Zvogëlimin e zhurmës**

Drunjtë dhe shkurret ndihmojnë në maskimin e zhurmës nëpër fëshfërimën e gjetheve, lëvizjeve të degëve në erë dhe tingujve të zogjve, insekteve dhe kafshëve të tjera. Ato mund të ndihmojnë po ashtu në zvogëlimin e zhurmës përmes reflektimit, shmangies dhe absorbimit, dhe përdoren më së miri në kombinim dhe mbështetje me masa të tjera

për zvogëlimin e zhurmës. Hulumtimet tregojnë se gjethet janë pjesa më efektive e një druri për shpërndarjen e tingullit dhe se gjethet e mëdha janë më efektive se sa gjethet e vogla. Shkurret e ulëta dhe/ose gardhet përgjatë skajeve të një grupi drurësh mund të përmirësojnë reduktimin e tingujve.





Një peizazh urban i shëndetshëm, punëtor dhe i përtërirë me shumë drunj kërkon pajisje të cilësisë së lartë, praktikë të standardit të lartë dhe njerëz që kujdesen, nga kujdestarët deri te kontraktorët. Parimet Mbill/Mbroj theksojnë pikat kyçe që duhet ti dini për të pasur sukses atëherë kur të fillojë gërmimi.

# MBJELL/ MBROJ

- 1/ Njih burimin e drunjve
- 2/ Krijë strategji gjithëpërfshirëse të drunjve
- 3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera
- 4/ Krijë vende në harmoni me drunjtë
- 5/ Zgjedh drunjtë e duhur
- 6/ Kërko përfitime të shumëfishta

- 7/ Gjej dru të shëndoshë
- 8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë
- 9/ Krijë hisedarë
- 10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve
- 11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)
- 12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave



## Gjej dru të shëndoshë

### Objektivi

Mbill drunj të shëndoshë, të fortë që janë përcaktuar të lulëzojnë në mjedisin në të cilin janë destinuar të jetojnë.

### Dobitë

- Rrit shëndetin e drurit, një kontribuues kyç për shtimin e rritjes së pyjeve urbane.
- Redukton shkallën e dështimit të drunjve dhe shpenzimet e zëvendësimit që lidhet me të.
- Siguron vlerë më të mirë për paratë në procesin e gjetjes së drunjve.

7/ Gjej dru të shëndoshë

8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

9/ Krijo hisedarë

#### Lojtarët kyç

Kërko dhe mbështet standarde pune të cilësisë së lartë

**Zyrtar për drunj**

**Pronar zone**

**Komunitetet**

**Kujdestar drurësh**

**Kontraktues dhe**

**nënkontraktues**

**Organizata vullnetare për drunj**

Zgjero njohuritë, pronësitë dhe pjesëmarrjen

#### Veprimet kyçe

- **Kupto sistemin e prodhimit të drunjve dhe përdor specifikat**  
- **Kryej vizita në fidanishte**

- Bëje vëllimin e dheut prioritetin kryesor

- Siguro ujitje dhe mbikëqyrje të mjaftueshme

- Angazho individë të trajnuar për të bërë mbjelljen

- Hulumto teknologji të reja të mbjelljes

- Përfshij komunitetet lokale dhe staf të trajnuar

- Siguro që puna në dhe përreth drunjve të përmbush standardet e cilësisë

## Mjedisi

Një pyll urban i shëndetshëm fillon me një dru të fortë e të shëndetshëm në kohën e mbjelljes. Hulumtimi *Trees in Town II* ka konstatuar një humbje mesatare prej 23% të drunjtë e mbjellë rishtas në rrugë kryesore dhe 24% për drunjtë e mbjellë rishtas në hapësira publike. Mungesa e cilësisë në trungun e drurit që mbillet është ajo që duhet fajësuar pjesërisht për norma të tilla mbijetese, bashkë me kushtet joadekuate të mbjelljes (shiko Parimin 8) si dhe përkujdesje e mëtëjshme e varfër përgjatë fazës së formimit (shiko Parimin 12).

## Veprimet

### Përdor specifikat për të pasur drunj më të shëndetshëm të rritur në fidanishte

Specifikat janë pjesërisht të rëndësishme në përpjekjen për të siguruar që drunjtë e blerë nga fidanishtet janë të cilësisë më të lartë dhe përputhen me qëllimin. Kjo duhet të përfshijë detajet e qarkut të trungut, lartësisë së drurit, trungut kryesor, dhe strukturës së degëve. Gjithashtu mund të specifikohen tipare shtesë siç janë pjerrësia e trungut dhe norma e diametrit lartësi/trung. Sidoqoftë këto tipare janë pamore dhe i referohen vetëm gjendjes morfologjike të drunjve dhe nuk kanë asnjë domethënie për gjendjen fizike. Është e mundur të kërkohen prova të shëndetit të mirë fiziologjik, po ashtu një numër testesh jo invazive dhe që kryhen lehtë janë aktualisht të disponueshme.

Specifikat duhet të përdoren edhe për përshkrimin e pritjeve të dërgesës dhe gjatësia e kohës që drunjtë e furnizuar kanë kaluar në fidanishten furnizuese. Drunjtë e importuar shpesh transferohen nga një kamion në një tjetër teksa arrijnë dhe dërgohen menjëherë. Kjo rezulton në specie tejet të stresuara të cilat janë gati për të dështuar. Një dru “i rritur në fidanishte” duhet të ketë kaluar së paku dy vjet në fidanishten e njëjtë. Kjo po ashtu siguron që drunjtë mund të kontrollohen plotësisht për insekte apo sëmundje para se të

transplantoen.

### Kuptoju sistemet e ndryshme të prodhimit të fidanishtes.

Sistemi i rrënjës së drunjve të rinj është qenësor për suksesin dhe jetëgjatësinë e tij në peizazh. Mënyra se si janë rritur sistemet e rrënjës dhe gjendja e tyre kur dërgohen drunjtë në destinacionin e tyre përfundimtar përcaktohet paraprakisht nga sistemi i përdorur i prodhimit të fidanishtes. Në MB, ekzistojnë tri sisteme kryesore prodhimi të fidanishteve: rrënjë e zhveshur, grumbullim sferik i rrënjëve dhe rrënjë me konteinerë. Secila ka përparësitë dhe mangësitë dhe nuk ekziston një e saktë apo e gabuar, por është me rëndësi të kuptohen dallimet dhe të jemi në gjendje të specifikojmë elementet që e bëjnë praktikën më të mirë.

### Kryej vizita në fidanishte për të siguruar përmbushjen e specifikave

Në mënyrë që drunjtë e marrë të jenë të shëndetshëm dhe të fortë, pa insekte, sëmundje dhe defekte mekanike si dhe të formuar mirë jo vetëm kërkojnë specifika të mira, por duhet të sigurojë vizitë te fidanishtja!

# 8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

## Objektivi

Siguro që drunjtë të kenë qasje në ushqim, oksigjen dhe ujë, atyre u duhet të përmbushin potencialin e tyre gjenetik për rritje dhe jetëgjatësi.

## Dobitë

-Prodhon vlera më të mëdha nga drunjtë: drunjtë që rriten më të gjatë, jetojnë më gjatë, dhe janë në gjendje të gjenerojnë 'shpagim'.

-Redukton nevojën për intervenime të jashtme: drunjtë kujdesen më mirë për vetveten.

- Ndërton një pyll urban përtëritës me një kapacitet të fuqishëm për adaptim.

7/ Gjej dru të shëndoshë

8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

9/ Krijo hisedarë

### Lojtarët kyç

Kërko dhe mbështet standarde pune të cilësisë së lartë

Zyrtar për drunjtë

Pronar zone

Komunitetet

Kujdestar drurësh

Kontraktues dhe

nënkontraktues

Organizata vullnetare për drunjtë

Zgjero njohuritë, pronësitë dhe pjesëmarrjen

### Veprimet kyçe

- Kupto sistemin e prodhimit të drunjve dhe përdor specifikat  
- Kryej vizita në fidanishte

- Bëje vëllimin e dheut prioritetin kryesor  
- Siguro ujitje dhe mbikëqyrje të mjaftueshme  
- Angazho individë të trajnuar për të bërë mbjelljen

- Hulumto teknologji të reja të mbjelljes  
- Përfshij komunitetet lokale dhe staf të trajnuar  
- Siguro që puna në dhe përreth drunjve të përmbush standardet e cilësisë

## Mjedisi

### Kapaciteti prodhues i drurit rritet në masë të madhe me rritjen e tij.

Për përfitim më të madh shoqëror, ekonomik dhe mjedisor me investim në pyll urban, nevojiten shumë drunj të mëdhenj, posaçërisht në zonat më të rrezikuara mjedisore siç janë rrugët, parkingjet e veturave, si dhe çarshitë. Këto vende kanë dy gjëra të përbashkëta që i bëjnë të pafavorshme për drunjtë: më se 90% e sipërfaqes së papërshkueshme dhe dhera tejet të shtresuara. Dherat nën trotuare janë tejet të shtresuara për të plotësuar nevojat e mbajtjes së ngarkesës. Kjo shpesh i bën rrënjët të ndalojnë së rrituri, duke i detyruar ato të grumbullohen në një vëllim shumë të vogël të dheut pa ujë, ushqim apo oksigjen të nevojshëm. Më pas, drunjtë urban me shumicën e rrënjëve të tyre nën sipërfaqet e shtruara rriten vështirë dhe vdesin para kohe. Drunjtë që mbijetojnë në një mjedis të tillë shpesh ndërhyjnë në trotuar. Derisa ndonjëherë në fillim shkaktojnë shpenzime të larta instalimi, një peshim më i mirë i vëllimit të dheut prodhon shumë më pak burime të rezultateve të shkapërdara.

## Veprimet

### Fut para në drunj dhe në ofrimin e kushteve adekuate të dheut për ta

Mund të shpenzohet shumë në mbrojtësit e drurit dhe “aksesorë” të tjerë për drunjtë urban. Në disa kontekste, kjo është gjëja e duhur për të siguruar mbrojtje adekuate për një dru të ri pa e minuar cilësinë urbane të vendbanimit të tij. Të bësh një dru të ri dhe pajisjet e tij mbrojtëse që të duken tërheqëse mund të ndihmojnë të frymëzojnë respekt dhe ta kufizojë vandalizmin. Në situata të tjera, aksesorë të tillë mund të jenë dëmtes pozitiv të drurit që e ka lënë pa mbikëqyrje të duhur.

Në të gjitha rrethanat, përparësi e qartë duhet t'i jepet garantimit se paratë shkojnë te vetë druri në rend të parë (shiko Parimin 7), si dhe

sigurimit të dheut adekuat për rritje. Në zona të dendura urbane, sasia e dheut të instaluar në një masë të madhe do përcaktojë madhësinë që ai dru do arrijë gjatë jetës së tij. Kjo është dokumentuar dhe modeluar në SHBA, posaçërisht përmes punës së James Urban i cili ka përcaktuar raportin në mes të madhësisë së drurit dhe vëllimit të dheut.

Rekomandohet fuqishëm përdorimi i standardeve të vëllimit të dheut për mbjelljen e drunjve në mjedise të shtruara urbane si çështje e politikave, dhe përmes përdorimit e një gjendje të planifikuar për menaxhimin e zhvillimeve private nga autoritetet lokale (shiko Parimin 3).

### Sigurohu që mbjellja të kryhet nga individë të trajnuar apo drejtuar në mënyrë të duhur, e përcjellë me mirëmbajtje të duhur të periudhës pas mbjelljes


Për mbjellje të suksesshme të drurit kërkohet njohuri dhe shkathtësi, megjithatë shpesh i lihet atyre që s'kanë gjë tjetër për të bërë në atë kohë. Për të shmangur gabimet e thjeshta siç janë dëmtimi i rrënjëve, mbjellja e drurit shumë thellë apo shumë lart, apo mbështetja e drurit në mënyrë të gabuar, është me rëndësi të sigurohet se ata që e bëjnë mbjelljen janë ose të trajnuar ose të mbikëqyrur (shiko Parimin 9 për kontraktorët).

Mungesa e ujit është një nga shkaktarët kryesor për dështimin e drunjve të mbjellë rishtas. Inicimi i një fushate për mbjelljen e drunjve në rrugë, parqe apo çfarëdo hapësire urbane pa një kuptim të qartë se kush do i ujisë drunjtë për dy sezonet e para të rritjes, dhe se si do ta bëjnë atë mund të çojë në një raport shumë të lartë të dështimit të drunjve (50-100%).

### Përdor teknologjitë më të reja

Një varg masash konstruktive janë bërë të disponueshme për të përmbushur nevojën e mbajtjes së peshës për një instalim të sigurt strukturor të trotuarit derisa rritet masa e hapësirës së rrënjës për drunjtë urban dhe

nxitja e rritjes së rrënjëve larg trotuarit. Kjo përfshinë rrugët e rrënjëve, dheun strukturor dhe sistemet e prera të trotuarit dhe secili ka dobitë dhe mangësitë. Kërko udhëzime të ekspertëve për të identifikuar qasjen më të mirë për projektin tuaj.



# 91/ Krijo hisedarë

## Objektivi

Puno me hisedarët lokal politik, profesional dhe nga komuniteti për të përkrahur vlerën e drunjve në peizazhin e qytetit.

## Dobitë

- Fuqia është te numrat.
- Redukton presionin në burimet e brendshme duke ndërtuar gamë më të gjerë të partnerëve që mund të sjellin fonde shtesë apo kapacitet shpërndarës.
- Redukton konfliktet dhe ankesat e shoqëruara me drunj të bezdisë.

71/ Gjej dru të shëndoshë

81/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

91/ Krijo hisedarë

### Lojtarët kyç

Kërko dhe mbështet standarde pune të cilësisë së lartë

**Zyrtar për drunj**

**Pronar zone**

**Komunitetet**

**Kujdestar drurësh**

**Kontraktues dhe nënkontraktues**

**Organizata vullnetare për drunj**

Zgjero njohuritë, pronësitë dhe pjesëmarrjen

### Veprimet kyçe

- Kupto sistemin e prodhimit të drunjve dhe përdor specifikat
- Kryej vizita në fidanishte
- 
- Bëje vëllimin e dheut prioritetin kryesor
- Siguro ujitje dhe mbikëqyrje të mjaftueshme
- Angazho individë të trajnuar për të bërë mbjelljen
- 
- Hulumto teknologji të reja të mbjelljes
- Përfshij komunitetet lokale dhe staf të trajnuar
- Siguro që puna në dhe përreth drunjve të përmbush standardet e cilësisë

## Veprimet

### Mendojeni krijimin e një partneriteti apo forumi strategjik për drunjtë

Një forum lokal që mbledh organizatat, grupet dhe individët që duan të mbrojnë dhe përmirësojnë drunjtë lokal ofron një mekanizëm efektiv për të:

-Promovuar koordinim dhe komunikim efektiv në mes të shërbimeve të ndryshme të këshillit (duke përfshirë parqet, rrugët kryesore dhe planifikimin), agjencitë e parashikuara me statut, organizata kyçe mjedisore dhe grupe të komunitetit lokal si dhe vullnetarë.

-Rritur mundësitë e tërheqjes së fondeve të jashtme dhe sponsorizimeve, shërbimeve të cilat mund të mos jenë të përshtatshme për ofrim, ose mund të përpigën të ndahen brenda buxhetit të këshillit.

-Dhënë komunitetit më të gjerë pronësi më të mëdha ndikimi për çështjet e drunjve.

-Ofruar një mjet për mbështetjen e zhvillimit dhe më e rëndësishmja, zbatimin e strategjisë lokale.

### Përfitoni nga ekspertët e drunjve të komunitetit dhe/ose një skemë Kujdestarie Drurësh

Pylltaria urbane ka të bëjë me njerëzit po aq sa me drunjtë prandaj mirëmbajtja e një pylli të shëndetshëm urban kërkon kontakt dhe mbështetje nga brenda komunitetit. Derisa ngritja e grupeve të vullnetarëve kërkon kohë, shpagimi është qenësor në furnizimin me vesh, sy dhe duar të përkushtuara për të arritur shumë përtej asaj çka burimet e përbashkëta mund të kishin arritur. Qyteti i vogël Hackney në Londër e ka zvogëluar raportin e dështimit të drunjve të rrugës të mbjellë rishtas në vetëm 1% duke rekrutuar ekspertë të drunjve nga komuniteti për të kryer konsultimet dhe për të koordinuar kujdesin e mëtejshëm. Vullnetarët lokal, siç janë ata të përfshirë në Skemën e Kujdestarisë së Drunjve të koordinuar nga Këshilli i Drunjve, mund të kryejnë disa mbjellje të drunjve, ti monitorojnë çështjet shëndetësore, të punojnë me shkollat, të ngrenë fonde, të

përfshihen në çështjet e drunjve të lidhura me zhvillimin e vendeve dhe të menaxhojnë avokimin për drunjtë.

### Organizo trajnimin e stafit dhe anëtarëve

Është shumë me rëndësi që të ketë një kuptim proporcional të detyrave, rreziqeve, dobive dhe praktikave më të mira bazë për menaxhimin e drunjve në mes të profesionistëve vendimet e të cilëve ndikojnë në burimet e drunjve vendorë. Duhet të shfrytëzohet përparësia e plotë e mundësive për të përfituar nga ekspertiza e autoriteteve lokale për drunjtë për të mbajtur sesione trajnim të stafit në planifikim, rrugë apo banim.


### Kërko nga kontraktorët që të demonstrojnë nivelin e duhur të vetëdijes dhe kualifikimeve për drunjtë

Propozimet dhe deklaratat e punës për ndërtimin dhe mirëmbajtjen rreth drunjve duhet të jetë e qartë sa i përket nivelit të kualifikimit. Kontraktorët që kryejnë punën me drunjtë duhet të ofrojnë prova të sigurimit adekuat dhe një kualifikim profesional të pemëtarisë. Kontraktorët që punojnë afër drunjve (që është pothuajse kushdo që kryen punë në rrugë) duhet të demonstrojnë po ashtu vetëdije të duhur mjedisore. Për shembull, qyteti i vogël Islington në Londër kërkon akreditim me ISO 9001 për të gjithë kontraktorët që kryejnë punë në rrugët e tij. Dokumentet e ofertave, kontratat si dhe politikat e përbashkëta duhet të kumtojnë në mënyrë shumë të qartë pritjet e praktikave më të mira që duhet ndjekur:

- Të gjithë kontraktorëve që punojnë në afërsi të drunjve duhet tu kërkohej të pajtohen me Standardin Britanik 5837:2012 Drunjtë në raport me dizajnin, shkatërrimin dhe ndërtimin – Rekomandimet.
- Kontraktorëve që punojnë në rrugë kryesore duhet tu kërkohej të punojnë sipas versionit të korrigjuar të Udhëzuesit për Planifikim, Instalim dhe

Mirëmbajtje të Aparatit Infrastrukturor në Afërsi të Drunjve të National Joint Utilities Group (NJUG).


- Kontraktorët që punojnë drejtpërdrejt me drunjtë duhet të ndjekin Standardin Britanik 3998:2010 për Punët me Drunjtë. Kontratat dhe politika e përbashkët duhet ta bëjë të qartë se do të kërkohet kompensim në rast të mospajtitimit dhe dëmtimit të drunjve. Më e rëndësishmja, nëse/kur të ndodhë prishja, duhet të bëhet zbatimi.





**Ndryshe nga pjesa më e madhe e infrastrukturës tradicionale e gjetur në sferën urbane, e cila shkatërrohet me kohë, në përgjithësi sa më të moshuar drunjtë, aq më shumë rezultate prodhojnë. Parimet Menaxho/Monitro ofrojnë një udhëzues për përkujdesje efektive ndaj këtij burimi të vlefshëm.**

# MENAXHO/ MONITORO



1/ Njih burimin e drunjve

2/ Krijë strategji gjithëpërfshirëse të drunjve

3/ Fut drunjtë në Politikë dhe Plane të tjera

4/ Krijë vende në harmoni me drunjtë

5/ Zgjedh drunjtë e duhur

6/ Kërko përfitime të shumëfishta

7/ Gjej dru të shëndoshë

8/ Siguro dhe, ajër dhe ujë

9/ Krijë hisedarë

10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

# 10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

## Objektivi

Shpalos të gjitha vendimet për planifikim, menaxhim dhe investim me një arsyetim të fuqishëm të shpenzimeve dhe të vlerave që paraqesin drunjtë.

## Dobitë

- Optimizon shpenzimet dhe përfitimet nga drunjtë në mënyrë strategjike.
- Përdor praktikat më të mira për të artikuluar nevojat për burime: këshilltarët e kuptojnë se po votojnë për një alokim burimesh me një sasi dhe vlerë të njohur.
- Merr participim dhe mbështetje më të gjerë për rezultatet e gjeneruara nga pylli urban.

10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

### Lojtarët kyç

Zgjedh intervenimet proaktive në vend të atyre reaktive

### Pronar zone

Zyrtar për drunj  
Autoriteti i rrugës kryesore

Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve

### Sigurimet

### Roje pyjesh

Kushtoji vëmendje dobive para kohës

### Veprimet kyçe

- Vlerëso vlerën e burimeve të drunjve
- Shkallëzo buxhetin dhe kompensimet në përputhshmëri
- 
- Kupto detyrën tënde për tu kujdesur
- Menaxho rreziqet dhe dobitë në varg
- Arsyeto inspektimin e drunjve përmes zonimit
- 
- Kompjuterizo çështjet e prerjes, menaxhimit dhe inspektimit
- Promovo menaxhmentet që kujdesen për biodiversitetin
- Merr parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike

## Mjedisi

Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (Iso) përcakton menaxhimin e aseteve si “aktivitetet e koordinuara të një organizate për të realizuar vlerën e ciklit jetësor nga asetet në këmbim të objektivave të veta” (burimi: drafti i Standardit për Menxhimin e Aseteve ISO 55000).

Aplikimi i qasjes për menaxhimin e aseteve në raport me pyllin urban i vë drunjtë në një pozicion më të barabartë me ifrastrukturën e hirtë për vendimmarrjen duke aplikuar një kornizë të ngjashme bazuar në shpenzimet, përfitimet dhe rreshtimin me objektivin e përgjithshëm.

Ai po ashtu ndihmon të sigurojë se vendimmarrja pranon se drunjtë janë njëra prej aseteve në ndërtimin e ambientit që vlerësohet me kohë.

## Veprimet

### Vlerëso peshën e burimit të drunjve lokal

Aktualisht janë të disponueshme një numër i metodave të vlerësimit të vlerës së drunjve. Secila ka perspektivë tjetër në përcaktimin e vlerës së drunjve duke i klasifikuar ata nga shpenzimet vetëm për zëvendësim, te përpjekja e një vlerësimi më gjithëpërfshirës të vlerave si strukturore (vlera e brendshme) ashtu edhe funksionale (përdor vlerën e shoqëruar me përfitime shoqërore dhe mjedisore).

Kjo përfshinë:

-Çmimin e zhvlerësuar të zëvendësimit (DRC), e cila i vlerëson drunjtë bazuar në shpenzimet e zëvendësimit.

-Helliwell, e cila bazohet në një numër faktorësh (vendi, madhësia, gjendja, forma, etj.) që u jepen vlera numerike dhe shumëfishohen me një figurë monetare të indeksuar.

-Metoda Capital Asset Value Amenity Trees (CAVAT), e cila bazohet në çmimet e zëvendësimit si dhe vlerën e drurit të komunitetit (përmes përdorimit të Indeksit të

Drurit të Komunitetit, e cila e vlerëson numrin e njerëzve që ndërveprojnë me drunjtë, dhe madhësinë e kurorës).

-i-Tree Eco, e cila vlerëson edhe vlerën strukturore të drunjve (bazuar në shpenzimet e zëvendësimit) edhe vlerën e dobive mjedisore që sjell ai, siç është izolimi dhe ruajtja e karbonit si dhe ndërprerja dhe heqja e ndotjes së ajrit.

Disa metoda, siç është ajo e Zhvlerësimit të Çmimit të Zëvendësimit janë dizajnuar për gjykimin e specieve individuale. Të tjera si i-Tree Eco, funksionojnë më mirë në shkallë më të gjerë.

### Integro rezultatet e vlerësimit në vendimmarrje.

Rezultatet nga vlerësimi mund të përdoren për të mbështetur një varg të gjerë aktivitetesh, duke përfshirë:

-Planifikimin strategjik – për të sqaruar shërbimet kryesore të ofruara nga pylli urban dhe se si krahasohen ato me prioritetet dhe pritjet lokale.

-Planifikimi financiar – praktikrat më të mira të menaxhimit të aseteve rekomandojnë që sasia e shpenzuar në menaxhim dhe mirëmbajtje është e barabartë me vlerën e asetit.

-Menaxhimi i rrezikut – për të balancuar rrezikun dhe përfitimet.

-Çështjet e kompensimit për dëmtimin e drunjve publik – kur nuk janë ndjekur direktivat e NJUG (shiko Parimin 9). Si për shembull, Këshilli i Qytetit të Bristolit raporton të ketë mbledhur 200,000 funte nga shërbimet komunale si rezultat i përdorimit të CAVAT.


-Rastet e rrëshqitjes – për të kontribuar në nivelin e provave siç rekomandohet nga Strategjia për Kufizimin e Rrezikut e Zyrtarëve për Drunj në Londër (shiko Parimin 11).

### Mos lejo që të bie nga zinxhiri i vlerave plehu i gjelbër i prodhuar nga drunjtë.

Plehu i gjelbër i prodhuar nga drunjtë duhet të kthehet në burim nga i cili përfiton pronari i drurit, se sa të dërgohet nëpër gropa

deponishë, apo të ofrohet si kompensim shtesë i kontraktorëve. Menaxhimi rutinor i drunjve mund të gjenerojë byk, dru zjarri, apo tipe të tjera të lëndës djegëse.

Kjo mund të sigurojë kursime të mirëseardhura shpenzimesh siç janë shpenzimet e reduktuara për blerjen e bykut, apo burime plotësuese nga shitjet. Më 2010, Leeds ka gjeneruar 15,000 funte nga shitja e druve të zjarrit. Londra ka ngritur Stacionin e Drunjve Croydon dhe Qendrën e Lëndëve Djegëse të Londrës Veriore. Menaxhimi i kujdesshëm nevojitet për të siguruar që kjo nuk i drejton në mënyrë të gabuar praktikrat e menaxhimit, duke rezultuar në boshatisje të burimeve të drunjve.



# 11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

## Objektivi

Zgjedh qasje të balancuar dhe proporcionale për menaxhimin e sigurisë së drunjve.

## Dobitë

- Plotëson detyrën e kujdesit përbrenda kufizimeve buxhetore.
- Siguron kënaqësi dhe shpagim maksimal nga drunj të lokal.
- Redukton potencialin për konflikte me politika të biodiversitetit dhe obligime.

10/ Zgjedh Qasjen e Menaxhimit të Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm ndaj Rrezikut (se sa Kundërshtues i Rrezikut)

12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

### Lojtarët kyç

Zgjedh intervenimet proaktive në vend të atyre reaktive

### Pronar zone

Zyrtar për drunj  
Autoriteti i rrugës kryesore

Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve

### Sigurimet

### Roje pyjesh

Kushtoji vëmendje dobive para kohës

### Veprimet kyçe

- Vlerëso vlerën e burimeve të drunjve
- Shkallëzo buxhetin dhe kompensimet në përputhshmëri
- Kupto detyrën tënde për tu kujdesur
- Menaxho rreziqet dhe dobitë në varg
- Arsyeto inspektimin e drunjve përmes zonimit
- Kompjuterizo çështjet e prerjes, menaxhimit dhe inspektimit
- Promovo menaxhmentet që kujdesen për biodiversitetin
- Merr parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike

## Mjedisi

Çdo vit në MB vdesin pesë apo gjashtë njerëz nga drunjtë që bien mbi ta. Ky raport fataliteti bie në tre kur përqendrohemi te drunjtë në hapësirat publike. Me që pothuajse e gjithë popullata britanike është e ekspozuar ndaj këtij rreziku, rreziku për person është rreth 1 në 20 milionë. Rreziku që një dru të shkaktojë fatalitet është një në 150 milionë për të gjithë drunjtë në Britani apo një në 10 milionë për ata drunj në apo afër zonave të përdorimit të lartë publik (burimi: <http://www.hse.gov.uk/lau/lacs/23-22.htm>). Në bazë të krahasimit, rreziku vjetor për person për vdekje në një aksident rrugor është një në 16,890.

## Veprimet

### Krijo dhe komuniko një kornizë të qartë për menaxhimin e rreziqeve dhe dobive

Strategjia (shiko Parimin 2) siguron një mjet për përcaktimin e një procesi transparent dhe të parashikuar për menaxhimin e sigurisë së drunjve. Ajo po ashtu lejon gjykim të përbashkët të menaxhimit të rrezikut të drunjve (qoftë ai rrezik ndaj njerëzve apo ndaj strukturave) dhe përfitimeve nga drunjtë për të krijuar një konsensus për pranimin e veprimeve tregtare. Metodatat e sigurisë që përdoren për strukturat (dështim i peshës, ngarkimit, etj.) nuk janë vërtetë të transferueshme te drunjtë, të cilët janë organizma të gjallë dhe prandaj më pak të parashikueshme. Derisa rreziqet nuk mund të eliminohen, ato mund të menaxhohen përmes një vargu përgjigjesh, duke përfshirë:

- Rënien e degëve apo drunjve: inspektim i bazuar në zonimin sipas përdorimit.
- Rrezikun e ecjes në trotuar: përdorimi i materialeve fleksibile të sipërfaqes, vëllim adekuat i dheut dhe standarde për mbjelljen e drunjve.
- Rrëshqitjen: shënjimi i pikave të nxehta, shartimi ciklik, procedimi i bazuar në dëshmi.
- Sëmundjet dhe insektet me ndikim të mundshëm në shëndetin publik (për shembull

irritimet dhe reaksionet alergjike të shkaktuara nga tenja e dushkut): programet e bashkëpunimit për çrrënjosje dhe përfshirje duke përfshirë një varg të gjerë hisedarësh sikurse edhe publikun në përgjithësi.

### Kupto çka do të thotë detyra e kujdesit në raport me drunjtë

Ligji kërkon që njerëzit “të kushtojnë kujdes të arsyeshëm për të shmangur veprimet apo lëniat anash që shkaktojnë rrezik të parashikueshëm të dëmtimit të personat apo pronat”. Më hollësisht, kjo ndikon që pronarët e tokës me drunj të kenë nevojë ti inspektojnë drunjtë e tyre në mënyrë periodike nga një person kompetent.

### Racionalizo inspektimin përmes zonimit sipas niveleve të përdorimit

Teksa buxhetet janë të kufizuara, është me rëndësi ti jepet përparësi alokimit të burimeve për zonat me rrezik më të madh. Kjo ka të bëjë më pak me gjendjen e drurit se sa me nivelin e përdorimit të tokës në të cilin qëndron druri. Për shembull, drunjve në zonë të përdorimit të lartë mund tu duhet të inspektohen çdo vit, derisa drunjtë në një zonë me nivel qasje shumë të ulët mund të mos u duhet asnjë inspektim zyrtar fare. Kjo qasje ndihmon të kujdesemi që siguria e hulumtimeve të mos ketë shumë shpenzime në kohë dhe buxhet.

### Krijo një proces të qartë- të mbështetur nga politikat- për trajtimin e dëmtimit struktural të drunjve

Trees in Towns II ka zbuluar se më pak se një në tre autoritete lokale ka politika zyrtare për menaxhimin e drunjve në raport me përgjegjësinë e tyre për dëmtimin e strukturës së drunjve. Dështimi për të adresuar përgjegjësinë potenciale në këtë zonë përmes prodhimit të politikave mund të jetë e kushtueshme për autoritetet lokale në planin afatgjatë. Strategjia për Kufizimin e Rrezikut e Zyrtarëve për Drunj në Londër, ku qytetet e vogla të Londrës siç është Islingtoni e përdorin si politikë, përfshinë një numër rekomandimesh të dobishme.

# 12/ Rregullo Menaxhmentin sipas Nevojave

## Objektivi

Kryej mirëmbajtje proaktive të drunjve për të siguruar optimumin e dobive në përgjigje të nevojave lokale.

## Dobitë

- Ndërton mbështetjen për drunjtë duke siguruar që dobitë peshojnë më shumë se telashet.
- Siguron norma më të larta të mbijetesës së drunjve.
- Përmirëson kontributin që drunjtë japin në biodiversitetin lokal.

10/ Zgjedh Qasjen e  
Menaxhimit të  
Aseteve

11/ Bëhu i Vetëdijshëm  
ndaj Rrezikut (se sa  
Kundërshtues i  
Rrezikut)

12/ Rregullo  
Menaxhmentin  
sipas Nevojave

### Lojtarët kyç

Zgjedh intervenimet proaktive në vend të atyre reaktive

### **Pronar zone**

Zyrtar për drunj  
Autoriteti i rrugës kryesore

Shoqëritë e bizneseve dhe banorëve

### **Sigurimet**

Roje pyjesh

Kushtoji vëmendje dobive para kohës

### Veprimet kyçe

- Vlerëso vlerën e burimeve të drunjve
- Shkallëzo buxhetin dhe kompensimet në përputhshmëri
- 
- Kupto detyrën tënde për tu kujdesur
- Menaxho rreziqet dhe dobitë në varg
- Arsyeto inspektimin e drunjve përmes zonimit
- 
- Kompjuterizo çështjet e prerjes, menaxhimit dhe inspektimit
- Promovo menaxhmentet që kujdesen për biodiversitetin
- Merr parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike

## Veprimet

### Përvetëso një qasje proaktive dhe sistematike për mirëmbajtjen e drunjve

Për të realizuar çfarëdo objektiv të planifikuar, menaxhimi praktik i pyllit urban duhet të ndërmerret në mënyrë sistematike.

Menaxhimi sistematik do të ndihmohej nga:

-Posedimi i një strategjie që përcakton objektivat e qarta dhe prioritetet për menaxhimin dhe rritjen e burimeve vendore të drunjve (shiko Parimin 2).

-Inspektimi sistematik dhe ciklik i drunjve (shiko Parimin 1 dhe 11).

-Përdorimi i sistemeve të kompjuterizuara për të menaxhuar dhe ruajtur informatat e hulumtimeve (shiko Parimin 1), si dhe të inspektimeve dhe punëve.

-Për autoritetet lokale: posedimi i një ekipi të integruar për menaxhimin e drunjve apo mbarrësh të fuqishëm bashkëpunues në mes të departamenteve.

Të kombinuara, këto elemente do të ndihmojnë të sigurojnë që shumica e punimeve për mirëmbajtjen e drunjve është proaktive dhe e programuar, më shumë se sa e atypëratyshme dhe reaktive. Dohitet përfshijnë shtim të shëndetit të drunjve, ankesa më të vogla dhe miratim të sigurimeve për drunjtë si dhe vlerë më të mirë të parasë.

### Promovo menaxhimin e qeverive që kujdesen për jetëgjatësinë dhe biodiversitetin e drunjve.

Drunjtë shumë në moshë dhe të sëmurë si dhe drunjtë me trup të vdekur e me zgavra sigurojnë vendbanim të vlefshëm për botën shtazore posaçërisht për lakuriqët, zogjtë dhe pakurrizorët. Për shembull qyteti i vogël i Londrës Waltham Forest e ka bërë politikë qendrore që "shembujt e drunjve me trup të vdekur dhe zgavra duke përfshirë drunjtë shumë të moshuar dhe me sëmundje do të ruhen në parqe, kopshte dhe zona pyjore për të ofruar vendbanim për botën shtazore (çështje e inspektimeve të shëndetit dhe

sigurisë së nevojshme)".

### Parashiko ndikimin e ndryshimit klimatik

Ndryshimi klimatik pritet të shkaktojë stres të shtuar fiziologjik për drunjtë që rriten brenda zonave urbane. Kjo, do të bëjë drunjtë të predispozuar për tu sulmuar nga një varg insektesh dhe patogjenësh. Ndryshimi klimatik pritet po ashtu të krijojë mjedis më të favorshëm për insekte të reja dhe patogjenë ndaj të cilave popullata e drunjve lokal nuk është ekspozuar më parë. Duke marrë parasysh këta skenarë, është shumë me rëndësi të kemi vetëdije të përmirësuar dhe bashkëpunim për të ndihmuar zbulimin e hershëm, si dhe ndarje të njohurive në mes të hisedarëve dhe pronarëve të drunjve, duke përfshirë këtu autoritetet lokale të lagjeve. Krijimi i aftësisë ripërtëritëse në popullatën e drunjve përmes zgjerimit të llojllojshmërisë së specieve dhe ndryshueshmërisë gjenetike është gjithashtu qenësore.

# REFERENCAT

No Trees, No Future. Trees and Design Action Group, 2008

[http://www.tdag.org.uk/uploads/4/2/8/0/4280686/no\\_trees\\_no\\_future.pdf](http://www.tdag.org.uk/uploads/4/2/8/0/4280686/no_trees_no_future.pdf)

The Canopy. Trees and Design Action Group, 2011

[http://www.tdag.org.uk/uploads/4/2/8/0/4280686/tdag\\_canopyweb.pdf](http://www.tdag.org.uk/uploads/4/2/8/0/4280686/tdag_canopyweb.pdf)

The Case for Trees. Forestry Commission, 2010

[http://www.forestry.gov.uk/pdf/eng-casefortrees.pdf/\\$FILE/eng-casefortrees.pdf](http://www.forestry.gov.uk/pdf/eng-casefortrees.pdf/$FILE/eng-casefortrees.pdf)

Trees in Your Ground. The Tree Council, 2005

[http://treecouncil.org.uk/index.php?page=shop.product\\_details&flypage=flypage.tpl&product\\_id=13&category\\_id=1&vmcchk=1&option=com\\_virtuemart&Itemid=4](http://treecouncil.org.uk/index.php?page=shop.product_details&flypage=flypage.tpl&product_id=13&category_id=1&vmcchk=1&option=com_virtuemart&Itemid=4)

Trees Matter: Bringing Lasting Benefits to People in Towns. National Urban Forestry Unit and Trees for Cities, 2005

[www.treesforcities.org/index.php/download\\_file/502/141/](http://www.treesforcities.org/index.php/download_file/502/141/)

Planning the Urban Forest: Ecology, Economy, and Community Development. James C. Schwab (ed.), American Planning Association, 2009

<http://www.planning.org/research/forestry/report.htm>

The benefits of large species trees in urban landscapes; a costing, design and management guide. CIRIA, 2012

<http://www.ciria.org/SERVICE/Home/core/orders/product.aspx?catid=2&prodid=2005>

Trees in Towns II. A new survey of urban trees in England and their condition and management. Chris Britt and Mark Johnston, for the Department of Communities and Local Government, 2008

<http://www.communities.gov.uk/publications/planningandbuilding/treesintownsii>

Tree Management Toolkit for Social Landlords – online resource developed by Neighbourhoods Green

<http://www.neighbourhoodsgreen.org.uk/resources/treemanagement>

Trees, People and the Built Environment. Forestry Commission Research Report. Mark Johnston, and Glynn Percival (Eds.) for the Forestry Commission, 2012.

[www.forestry.gov.uk/pdf/FCRP017.pdf/\\$FILE/FCRP017.pdf](http://www.forestry.gov.uk/pdf/FCRP017.pdf/$FILE/FCRP017.pdf)

# FJALOR

**Drunjtë antik:** Një dru që është i vjetër për specien e tij (p.sh. përtej kulmit të pjekurisë), një lidhje jetese me të shkuarën me një bukuri të rrallë zakonisht e lidhur me vendbanimin e botës shtazore nga drunjtë e vdekur dhe të shkatërruar.

**Menaxhimi i aseteve:** aktivitetet e koordinuara të një organizate për të realizuar vlerën e ciklit jetësor nga asetet në këmbim të objektivave të tij.

**Diametri:** diametri i trungut të drurit.

**Kurora pyjore:** përqindja e një zone të caktuar të mbuluar nga kurora e drurit.

**Izolimi i karbonit:** procesi përmes të cilit karboni atmosferik thithet në gropa karboni siç janë oqeanet, pyjet dhe dheu.

**Trungu qendror:** trungu i qartë dhe dominues në majë të një druri.

**Pagesa e shkëmbimit:** pagesë që bëhet nga zhvilluesi në vend të përvetësimit të drunjve të një vendi.

**Zonë konservimi:** zona të dizajnuara për mbrojtje të veçantë për shkak të interesit historik apo arkitekturor. Kushdo që propozon të krasis apo pres dru në një zonë të tillë duhet tu japë autoriteteve lokale njoftimin gjashtë javor për qëllimet e tyre. Kjo është për ti mundësuar këshillit studimin e propozimit dhe të vendosë nëse duhet apo jo të përdor TPO.

**Strategjia bërthamë:** ajo që dikur quheshin dokumentet statutare që e përbënin planin lokal para se të hynte në fuqi Korniza Kombëtare Planifikimit të Politikave në mars 2012. Ajo vendos vizionin e Autoritetit Planifikues Lokal, objektivat kryesore strategjike dhe mënyra se si do jepen ato.

**Hulumtimi i turmës:** praktika e sigurimit të shërbimeve, ideve apo përmbytjeve duke bërë thirrje për kontribute nga një grup i madh i njerëzve dhe posaçërisht nga

komuniteti online.

**DBH-Diametri në Lartësinë e Gjoksit:** diametri i trungut i matur 1.5 metra sipër tokës.

**Përmbledhjet e zhvillimit:** udhëzues jo-statutarë të përgatitur për vendbanime të një gjerësie të caktuar që pritet të jenë subjekt i zhvillimit. Përmbledhjet zakonisht përmbajnë detaje të drunjve me rëndësi që konsiderohen mjaftueshëm të vlefshëm për tu mbajtur.

**Dokumentet e Planit të Zhvillimit (DPD):** ajo që dikur quheshin dokumentet statutare që e përbënin planin lokal para se të hynte në fuqi Korniza Kombëtare Planifikimit të Politikave në mars 2012. Kjo përfshinë strategjinë bërthamë dhe DPD të tjera specifike për një zonë të caktuar që ofrojnë më shumë detaje për politika më të gjera të përfshira në strategjinë bërthamë.

**Detyra e kujdesit:** i referohet obligimeve me ligj ndaj drurit të pronarit të tij për të "pasur kujdes të arsyeshëm për shmangien e veprimeve apo heqjes që shkaktojnë rrezik të parashikueshëm të dëmtimit të personit apo pronës".

**Ekosistemi:** shkurtesë e sistemit ekologjik. I referohet bimëve, kafshëve dhe gjallesave të tjera që jetojnë së bashku në një hapësirë të caktuar me mjedisin e tyre dhe që funksionojnë si një njësi e lirë. Këto komponentë së bashku me ndërveprimet e tyre formojnë një tërësi të re dinamike dhe komplekse, që bart karakteristika që nuk mund të gjenden në komponentë të secilit individ vetëm.

**Qarku:** perimetri i trungut të drurit i matur 1 metër mbi tokë.

**Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS):** u lejon përdoruesve të shikojnë, kuptojnë, pyesin, përdorin, e interpretojnë të dhëna gjeografike në forma që përfshijnë hartat, raportet apo tabela që ndihmojnë në zbulimin e marrëdhënieve, mostrave dhe trendeve.

**Infrastruktura e gjelbër:** rrjeti i hapësirave të gjelbra dhe tipareve tjera natyrore brenda dhe përreth qyteteve të vogla dhe të mëdha të cilat ruajnë vlerat natyrore të ekosistemit dhe funksionon, mban ajër dhe ujë të pastër, dhe ofron një gamë të gjerë të përfitimeve për njerëzit dhe botën shtazore.

**Infrastruktura e hirtë:** pasuri dhe rrjete të ndërtuara siç janë rrugët, linjat e hekurudhave, urat, shërbime nëntokësore, spitale të dizajnuara për mbështetjen e vendbanimeve njerëzore – dhe të dizajnuara në mënyrë tradicionale për të zëvendësuar (më shumë se sa për të bashkëpunuar e integruar) sistemin natyror për të dhënë përfitimet e veta, ndonjëherë duke rezultuar me pasoja të dëmshme për mjedisin.

**Protokolli i Përbashkët i Lehtësimit:** metodë e miratuar nga siguresit e mëdhenj dhe Asociacioni i Zyrtarëve për Drunj në Londër për procedimin dhe hetimin e dëmtimit të ndërtesave të shtyra nga rrënjët e drunjve, me etapa kohore për përgjigje dhe standarde të dëshmimeve.

**Speciet bazë:** specie, prezenca dhe roli i të cilave brenda ka një efekt joproporcional me organizmat tjerë brenda ekosistemit.

**Vlerësimet e karakterit të peizazhit:** Mjeti i përdorur për të na ndihmuar të kuptojmë, dhe artikulojmë karakterin e peizazhit. Na ndihmon në identifikimin e tipareve që i japin një lokaliteti “ndjenjën e përkatësisë në një vend” dhe identifikon me saktësi ato që e bëjnë atë të rëndësishëm nga zonat fqinje.

**Vlerësimi i karakterit lokal:** një teknikë e përdorur për të zhvilluar një kuptim konsistent dhe gjithëpërfshirës të asaj se çka i jep peizazhit të një lokaliteti karakterin e tij dhe çka e bënë atë unik.

**Druri i pjekur:** definicioni i pjekurisë të drunjve është po aq i gjerë sa të njerëzit. Me siguri drunjve nuk konsiderohen të pjekur derisa ata të jenë në moshën kur riprodhojnë dhe bartin

fara, por shumë prej tyre do zgjaten e zgjerohen pasi të ketë arritur ajo pikë.

**Shtresimi:** procesi i ndarjes së të dhënave në grupe të veçanta apo të grumbulluara – për shembull një set i të dhënave të drurit mund të shtresohet duke përdorur pronësinë apo kriteret e përdorimit të tokës.

**Rrëshqitja:** lëvizja tatëpjetë e dheut që e mbanë një ndërtesë. Problemet dalin në pah kur lëvizja dallon nga një pjesë e ndërtesës në tjetrën kur mund të ndodhin çarjet dhe dëmtimet në strukturë.

**Dokumentet plotësuese të Planifikimit (SPD):** këto janë të përfshira në planin lokal për të ofruar më shumë detaje në politikat e përfshira në strategjinë bërthamë dhe në dokumentet e tjera të planit të zhvillimit që mund të përmbajë plani lokal. Termi daton para publikimit të Kornizës së Planifikimit Kombëtar, i cili erdhi në fuqi në mars 2012, e cila thjeshtoi përshkrimet e elementeve që duhet përfshirë në planin lokal.

**SuDS-Sistemet e Qëndrueshme të Drenazimit:** zgjidhjet që ofrojnë alternativë për sistemet tradicionale të kanalizimit që trajtojnë qarkullimin e ujit të reshjeve duke imituar proceset e drenazimit natyral. Pjerrësia: shkalla në të cilën trungu i një druri ulet në diametër si funksion i lartësisë mbi tokë.

**Procedura e Ruajtjes së Drunjve (TPO):** përdoren për të mbrojtur drunj të caktuar dhe pyje nëse heqja e tyre do të kishte “ndikim të rëndësishëm në mjedis dhe kënaqësitë e publikut”. Ato mund të aplikohen për një dru të vetëm për apo për një grup drurësh. Në përgjithësi përparësi i jepet drunjve që konsiderohet se janë të rrezikuara, për shembull kur propozohen zhvillimet e pashmangshme.

**Pylli urban:** drunj publik dhe privat të lokalizuar në dhe përreth një zone urbane.

**Pylltaria urbane:** qasje e planifikuar,

sistematike dhe e integruar në menaxhmentin e drunjve dhe zonave pyjore në dhe përreth qytete të mëdha dhe të vogla si përpjekje për të optimizuar përfitimet shoqërore, mjedisore dhe ekonomike për komunitetet lokale.

**Dru veteran:** një dru i cili, ndonëse nuk është akoma antik, ka rëndësi të botës së egër që vjen nga plakja natyrale dhe lëndimi ose nga tensioni apo dëmi i shkaktuar.



Drunjtë janë pjesë vitale e infrastrukturës urbane dhe ofrojnë një llojllojshmëri përfitimesh – hije në verë, strehë nga shiu dhe era; ata ndihmojnë ta mbajmë ajrin pastër dhe të mund të marrim frymë, e ndihmojnë botën e egër dhe i shtojnë vlerë kulturës dhe ekonomisë së qyteteve tona. Tani është koha të punojmë së bashku për të mbrojtur drunjtë urban që kemi dhe të mbjellim më shumë të tillë në mënyrë që ata të mbijetojnë dhe të ofrojnë këto dhe shumë më shumë përfitime në të ardhmen.”


Sue Holden, Shefe Ekzekutive e Woodland Trust



## EC Ma Ndryshe

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

*Vlerat kryesore të organizates janë:* 1. *Paanshmëria* - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion; 2. *Aktivizmi* - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës; 3. *Orientimi drejt rezultateve* - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe 4. *Komuniteti bazë e veprimit* - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.



[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)